



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 123 Akti**

**Nr. 189 Vendimi  
Tiranë, më 25.7.2019**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesuese
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Relatore
<b>Suela Zhegu</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datën 23.7.2019, ora 14:00, në Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Hysen Keta**, me detyrë prokuror/drejtues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Përmet, përfaqësuar personalisht.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

“**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Keta, me funksion prokuror dhe drejtues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Përmet, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 22.3.2018, të trupit gjykues nr. 1, pas studimit të raporteve të vlerësimit të sipërpërmendura, hartuar nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues, komisionere Xhensila Pine. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
4. Në datën 7.6.2018, subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues, për të cilin, në datën 11.6.2018, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Në datën 3.7.2019, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Hysen Keta, për të tria kriteret e rivlerësimit: kriterin e pasurisë, kriterin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e tij brenda 12 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
6. Në datën 4.7.2019, subjektit iu njoftuan rezultatet e hetimit dhe, po në këtë datë, konfirmoi në rrugë elektronike njohjen me rezultatet e hetimit kryesisht për rivlerësimin e tij.
7. Në datën 16.7.2019, subjekti i rivlerësimit dërgoi në rrugë elektronike prapësimet e tij, si dhe dokumentet justifikuese.
8. Në datën 17.7.2019, subjekti i rivlerësimit konfirmoi me anë të *e-mail*-it, por edhe në rrugë zyrtare, dërgimin e prapësimeve dhe dokumentacionin referues nr. (\*\*\*) prot., datë 17.7.2019.
9. Komisioni, gjatë studimit të prapësimeve të subjektit, konstatoi se subjekti, ndër të tjera, parashtronte se nuk dispononte të dhëna të plota në lidhje me udhëtimet e kryera në vitin 2005 mbi bazën e të cilave janë llogaritur shpenzimet *TIMS*, pasi edhe në dosjen e tij, të marrë me CD, nuk i rezultonin të pasqyruara. Mbi këtë pretendim të subjektit, Komisioni me *e-mail*-in datë 17.7.2019, ia vendosi në dispozicion, i cili në datën 19.7.2019 dërgoi dokumentacion justifikues<sup>1</sup> në lidhje me pagesën e shpenzimeve të udhëtimeve brenda/jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për vitin 2005.

<sup>1</sup> Referojuni *e-mail*-it të datës 19.7.2019, ku subjekti shprehet: “Këto janë dokumentet që kemi mundur të sigurojmë deri në këto momente.”

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

10. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në datën 18.7.2019, mori në shqyrtim edhe kërkesën e subjektit për caktimin e një eksperti vlerësues të pasurive të paluajtshme dhe, me vendimin e ndërmjetëm të datës 18.7.2019, vendosi të refuzojë kërkesën e tij pasi, bazuar në germën “a”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, marrja e provës dukej e panevojshme, duke ia komunikuar subjektit njohjen e këtij vendimi, si me anë të postës elektronike, ashtu edhe në rrugë zyrtare me nr. (\*\*\*) datë 19.7.2019. Gjithashtu, Komisioni me *e-mail*-in po të datës 19.7.2019, lidhur me dokumentacionin e depozituar në këtë datë, njoftoi subjektin se i pranoi ato për t’i shqyrtuar së bashku me prapësimet, si dhe çdo dokumentacion tjetër të depozituar më parë në datën 16.7.2019, për t’i vlerësuar me objektivitet gjatë procesit të vendimmarrjes.

11. Në datën 18.7.2019, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Hysen Keta, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 23.7.2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

12. Në datën 23.7.2019 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent.

### **II. SEANCA DËGJIMORE**

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Hysen Keta u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues, shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Hysen Keta. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 23.7.2019, për të rifilluar në datën 25.7.2019, për shpalljen e vendimit.

### **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Z. Hysen Keta ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; c) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; d) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; e) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; f) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

administrative si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

#### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për dosjen nr. (\*\*\*) me shkresën nr. (\*\*\*), datë 10.5.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personin e lidhur për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- *ka kryer deklarim të pasaktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka mosdeklarime të pasurive në deklaratat e interesave private në vite;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë “Vetting”, në zbatim të nenit 31/1<sup>2</sup>, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Keta, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 30.1.2017 (duke përfshirë personin e lidhur), në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe ky fakt konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Gjithashtu, në referencë të nenit 32/5<sup>3</sup>, të ligjit nr. 84/2016, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Keta, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi IND (\*\*\*)

#### **A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konfliktit të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

#### **Mbi kriterin e pasurisë**

Për pasuritë e deklaruara në deklaratën “Vetting”, sipas formularit (shtojca 2) të datës 30.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

<sup>2</sup> Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë në ILDKPKI.

<sup>3</sup> Deklarimet e interesave privatë dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.

## *Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta*

**1. Për deklarinin në lidhje me shtëpi banimi trekatëshe**, me sip. 190 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie (\*\*\*) , në shumën 2 200 000 lekë, ndërtuar në vitet 1996 – 2001 në truallin me sip. 550 m<sup>2</sup>, të trashëguar nga babai, i cili është i ndarë në 1/3 pjesë mes subjektit, motrës dhe vëllait të tij, ndodhur në Rr. “(\*\*\*)”, nr. (\*\*\*) , Tiranë. Pjesa takuese: 50% me bashkëshorten. **Burimi i deklaruar i krijimit:** Të ardhurat familjare ndër vite dhe të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit për periudhën 1993 – 1998.

1.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë, ka konstatuar: **Deklarim i pasaktë në deklaratën e interesave private “Para fillimit të detyrës 2003” të shtëpisë së banimit, lidhur me përshkrimin e objektit dhe të sipërfaqes së tij dhe konkretisht, deklaruar shtëpi banimi me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup>, referuar dokumentacionit të administruar rezulton shtëpi banimi 3 kate, me sipërfaqe 196.2 m<sup>2</sup> dhe mosparaqitje e dokumentacionit justifikues ligjor, si situacion dhe preventiv punimesh, lidhur me shpenzimet e kryera për ndërtimin e objektit të mësipërm.**

1.2 Nga hetimi administrativ rezultoi se kjo pasuri, në deklaratën për vitin 2003, është deklaruar me përshkrim *shtëpi banimi, 120 m<sup>2</sup>, në vlerën 2.2 milionë lekë, në adresën Rr. “(\*\*\*)”, (\*\*\*) , ndërtuar vetë, me kursime familjare, në pjesë takuese: 50%.*

1.2.1 Në deklaratën për vitin 2016, kjo pasuri është deklaruar me përshkrim *godinë banimi, me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, tre kate, Rr. “(\*\*\*)”, nr. (\*\*\*) , Tiranë, ndërtuar nga unë në vitet 1996 – 2003, në truallin e trashëguar nga babai, me të ardhurat nga puna si avokat, në shumën 2 200 000 lekë, legalizuar me leje (\*\*\*) , datë 17.8.2016, z.k. (\*\*\*) , nr. pasurie (\*\*\*) , në pjesë takuese: 50%.*

1.3 Nga aktet e ZVRPP-së<sup>4</sup> Tiranë rezultoi se:

- Kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë sipas kartelës përkatëse të pasurisë, në emër të subjektit të rivlerësimit, bazuar në lejen e legalizimit (\*\*\*) , datë 17.08.2016, si pasuri e llojit ndërtesë, me nr. (\*\*\*) , z.k. (\*\*\*) , vol. (\*\*\*) , f. (\*\*\*) . Në përshkrimin e veçantë të kësaj kartele është pasqyruar shënimi *“Leje legalizimi nr. (\*\*\*) , datë 17.8.2016, godinë banimi 3 kate, kati përdhe 60.0 m<sup>2</sup> (shkallë + verandë 9.6 m<sup>2</sup>), kati I, 63.3 m<sup>2</sup>, kati II 63.3 m<sup>2</sup>... vijon, vol(\*\*\*)f. (\*\*\*) VKM<sup>5</sup> parcele ref. (\*\*\*)”*. Në seksionin “E”, rezulton se kjo pasuri, deri në datën 18.5.2018 (datë e regjistrimit të kartelës së pasurisë) është e hipotekuar deri në shlyerjen e detyrimeve për llogari të ALUIZNI-t.

- Sipas lejes së legalizimit<sup>6</sup> rezulton se është legalizuar godinë banimi trekatëshe me sipërfaqe ndërtimi për banim 196.2 m<sup>2</sup>. Nga aktet e depozituara në praktikën e ALUIZNI-t rezulton se pasuria është ndërtuar pjesërisht në truallin e subjektit dhe pjesërisht në pronësinë e shtetit. Gjithashtu, po nga aktet e administruara në këtë praktikë rezultoi se ishin kryer pagesa (sipas mandatpagesave) për parcelë ndërtimore/pasurinë *shtet*, të zënë nga ndërtimi i kësaj pasurie. Nga verifikimet e bëra u konstatua se sipërfaqja e zënë e pasurisë *shtet* ishte e ndryshme nga ajo e përcaktuar në genplanin përkatës. Po ashtu, u vërejtën paqartësi në sipërfaqen e pasqyruar në genplan, krahasuar me sipërfaqen e paguar sipas mandatpagesave të depozituara edhe nga vetë subjekti, akte të njëjta me ato të administruara në dosjen e ALUIZNI-t.

- Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit<sup>7</sup> në lidhje me këto paqartësi, për të cilët deklaroi: *“Sipas formularit të pagesës së parcelës ndërtimore të hartuar nga drejtoria e ALUIZNI-t, rezulton se sipërfaqja e parcelës ndërtimore e paguar prej meje ka qenë 54.1m<sup>2</sup>, me vlerë 2000*

<sup>4</sup> Referojuni shkresës nr. (\*\*\*)prot., datë 20.5.2018 dhe dokumentacionit bashkëngjitur, kartelë e pasurisë së paluajtshme, në dosjen e Komisionit.

<sup>5</sup> Referuar VKM-së nr. 712, datë 1.12.2017 (fletore zyrtare nr. 27, datë 14.12.2017), në të cilën subjekti është renditur me nr. 806 si përfutës i sipërfaqes së tokës shtet me sip. 54.1 m<sup>2</sup>.

<sup>6</sup> Referojuni të gjithë praktikës nr. (\*\*\*)prot., datë 22.5.2018, të ALUIZNI-t, Tirana JUG, në dosjen e Komisionit, mbi të cilën është dhënë leja e legalizimit.

<sup>7</sup> Referojuni pyetësorit me tekst në e-mail-in datë 24.6.2019, në dosjen e Komisionit.

## **Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta**

(dy mijë) lekë për m<sup>2</sup>, e cila në total kap vlerën prej 108 200 (njëqind e tetë mijë e dyqind) lekësh. Sipas ligjit të kohës në të cilën është bërë pagesa, është aplikuar një zbritje për pagesën e menjëhershme dhe një zbritje për pagesën e rregullt të energjisë elektrike, duke përcaktuar përfundimisht detyrimin për pagesë, të shumës cash në masën 38 952 (tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy) lekë, dhe 54 100 (pesëdhjetë e katër mijë e njëqind) lekë në letra me vlerë... dua të theksoj se edhe sipërfaqja prej 54.1m<sup>2</sup> që rezultonte pronë shtet, është brenda oborrit të shtëpisë ekzistuese, të trashëguar nga babai im. Madje edhe përtej murit kufizues të oborrit të shtëpisë në fjalë ka qenë pronë e trungut tonë familjar, në një sipërfaqe përafërsisht prej 4000 m<sup>2</sup>. Ende sot nuk e kuptoj se si kjo sipërfaqe prej 54.1m<sup>2</sup>, e ndodhur brenda murit rrethues të oborrit të shtëpisë së vjetër, rezultonte pronë shtetërore, por duke qenë se për shtëpitë e vjetra dokumentacioni i gjendur pranë arshivës së shtetit apo në ZVRPP ka qenë i mangët, si dhe duke pasur parasysh faktin që procedurat për njohjen dhe kthimin e pronës ishin shumë të kushtueshme dhe merrnin shumë kohë, të cilën, për shkak të angazhimit në punë, unë nuk e kisha, u detyrova të bëj pagesën në fjalë. Subjekti ka qartësuar se sipërfaqja që ka pasur në pronësi përpara pagesës ka qenë 143.5m<sup>2</sup>, ndërsa pas regjistrimit janë shtuar 54.1 m<sup>2</sup>, duke pasqyruar totalin prej 197.6 m<sup>2</sup>. ”

- Subjekti vuri në dispozicion certifikatën e pronësisë përpara regjistrimit të VKM-së për kalimin në pronësi të sip. 54.1 m<sup>2</sup>, si dhe certifikatën e pronësisë pas regjistrimit të VKM-së në fjalë.

- Komisioni i kërkoi shpjegime<sup>8</sup> subjektit edhe në lidhje me pagesën e taksës së infrastrukturës për këtë pasuri, si dhe kërkoi të depozitohej dokumentet justifikues, për të cilën subjekti vuri në dispozicion të gjitha pagesat e kryera që i përkisnin parcelës ndërtimore dhe jo taksës së vlerës së investimit të ndërtimit të kësaj pasurie.

- Në përgjigjen e tij subjekti, ndër të tjera, deklaroi: “...kam përmbyshur çdo detyrim që më është caktuar nga organet kompetente, të cilat, në rastin konkret, kanë qenë drejtoria e ALUIZNI-it apo Bashkia Tiranë, duke paguar të gjitha shumat në vlerën dhe afatet e kërkuara prej tyre... Deklaroj me përgjegjësi të plotë se asnjëherë nuk më është treguar apo dhënë ndonjë formular ku të përcaktohej ndonjë detyrim për pagesën e ndonjë shume tjetër, përveç se atyre që kam ju kam dërguar...Duke kërkuar arsyet e mundshme të mungesës së këtij formulari dhe pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë... detyrimi im për pagesën e kësaj takse fillon nga momenti i llogaritjes dhe njoftimit të këtij detyrimi, njoftim i cili deri më sot nuk më është bërë, as nga drejtoria e ALUIZNI-t, as nga Zyra e Taksave pranë Bashkisë Tiranë...” Gjithashtu, subjekti deklaroi se do të ishte reflektuar barrë hipotekore në favor të Bashkisë Tiranë për mos shlyerje të detyrimeve në lidhje me këtë taksë, në një kohë që kartela e pasurisë është e pastër. Së bashku me deklaratimet, subjekti depozitoi një vendim të KLSH-së për Miratimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Tirana 2, për periudhën nga data 1.8.2014 – më 31.12.2016.

- Sipas formularit të plotësuar nga subjekti për legalizimin e kësaj godine banimi<sup>9</sup>, rezultonte e deklaruar se godina trekatëshe ishte ndërtuar në vitin 1996.

- Në lidhje me origjinën e kësaj pasurie (ku është ndërtuar edhe pasuria nr. 2 e përshkruar në këto rezultate hetimi), nga hetimi i akteve të administruara në dosje, të ardhura nga ZVRPP-ja Tiranë, rezultoi se:

<sup>8</sup> Referojuni pyetësorit datë 19.6.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>9</sup> Referojuni praktikës me nr. (\*\*\*) prot., datë 22.5.2018, të ardhur nga ALUIZNI, në dosjen e Komisionit.

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

- i. Me vendimin gjyqësor nr. (\*\*\*) , datë 5.3.1960, vërtetohej fakti i ndërtimit të pasurisë shtëpi dollmalije, e përbërë nga tri dhoma, një kuzhinë e verandë, në vitet 1959 e 1960, në truallin me sip. 550 m<sup>2</sup>, të dhuruar prej shtetasve Y., H. e Gj. B. .
- ii. Me vendimin gjyqësor nr. (\*\*\*) , datë 18.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ishte çelur dëshmia e trashëgimisë së trashëgimlënësve M. dhe H. Keta, përkatësisht babai dhe nëna e subjektit.
- iii. Sipas certifikatës së pronësisë lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë në datën 3.5.2013, kjo pasuri kishte kaluar në bashkëpronësi të trashëgimtarëve, më konkretisht, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe dy bashkëpronarëve A. dhe T. K. (në pjesë takuese 1/3) e regjistruar si pasuria me nr. (\*\*\*) , e llojit truall, me sip. 550 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 250 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë.
- iv. Me kontratën e pjesëtimit nr. (\*\*\*) , datë 26.4.2017, rezultonte se subjekti dhe dy bashkëpronarët e tjerë kishin pjesëtuar vullnetarisht truallin e pandarë në bashkëpronësi, me sip. 550 m<sup>2</sup>, nr. pasurie (\*\*\*) , regjistruar në z.k. (\*\*\*) , vol. (\*\*\*) , f. (\*\*\*) , ndodhur në Tiranë, si dhe ndërtesën mbi të me sip. 250 m<sup>2</sup>.
- v. Sipas pjesëtimit vullnetar rezultonte se subjekti ishte bërë pronar i pasurisë me sip. trualli 143,50 m<sup>2</sup> dhe me sip. ndërtesë 88.54 m<sup>2</sup>. Kjo pasuri konfirmohet e regjistruar në datën 4.5.2017, si pasuria me nr. (\*\*\*) , z.k(\*\*\*) , vol. (\*\*\*) , f. (\*\*\*) .
- vi. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit mbi përcaktimin e kostove të ndërtimit për secilin vit, për të cilat subjekti deklaroi<sup>10</sup> se ... *gjatë 2 (dy) viteve të para është kryer rreth 80 % e shpenzimeve të ndërtimit (vitet 1996 – 1997) dhe pjesa tjetër prej 20% e vlerës së shpenzimeve në pjesë të barabarta për çdo vit (1998 – 2001).*

- Subjekti depozitoi një aktekpertizë teknike në lidhje me shpenzimin total të ndërtimit, në të cilin thuhej se mënyra e përlllogaritjes përmban një opinion të pabazuar në legjislacion, por të përafërt me tregun informal të ndërtimit.

- Komisioni, në vlerësim të këtij akti, ka vërejtur se të dhënat e përdorura nuk bazoheshin në referenca ligjore, metodologji, apo standarde zyrtare të njohura në rastet e ndërtimeve me kosto të ulët, apo quajtur ndryshe minimaliste, të cilat kontraktohen për të pastrehët, për të provuar vërtetësinë e shumës së shpenzuar për ndërtimin e kësaj pasurie trekatëshe.

- Komisioni, për shkak të vlerave të ndryshme të deklaruara apo pasqyruara për ndërtimin e kësaj pasurie, përkatësisht asaj të deklaruar në shumën 2.2 milionë lekë dhe kostove ndërtimore të pasqyruara nga Enti Kombëtar i Banesave, u bazua në koston mesatare vjetore të shfrytëzimit të përcaktuar nga ky i fundit<sup>11</sup>, duke kryer përlllogaritjen e shpenzimit që duhet të ishin bërë për ndërtimin e kësaj pasurie, pasqyruar në tabelën e mëposhtme, si dhe në referencat për:

- vitet kalendarike të deklaruara nga subjekti se kanë shërbyer për ndërtimin e kësaj pasurie;
- vlerën e shpenzuar për m<sup>2</sup> për sipërfaqe ndërtimi të shfrytëzueshme;
- sipërfaqen e ndërtimit të kësaj pasurie (190 m<sup>2</sup>), siç është deklaruar në deklaratën “Vetting”;
- sipërfaqen e ndërtuar për secilin vit, sikurse subjekti ka deklaruar në pyetësor se kishte ndërtuar 80% të pasurisë në dy vitet e para të nisjes së ndërtimit, përkatësisht në vitet 1996 – 1997;
- vlerën e shpenzuar për ndërtimin e kryer në secilin vit kalendarik, sipas çmimit të EKB-së.

### **Tabela nr. 1**

<sup>10</sup> Referojuni pyetësorit nr. 2, datë 6.5.2019, në dosjen e Komisionit, si dhe pyetësorit nr. 3, datë 27.5.2019.

<sup>11</sup> Vendim nr. 13, datë 5.1.1998; vendim nr. 214, datë 28.4.1999; vendim nr. 362, datë 17.7.2000; udhëzim nr. 5, datë 31.5.2001. Në udhëzimin nr. 5, datë 31.5.2001, është marrë kosto mesatare për sipërfaqe shfrytëzimi në qytetin e Tiranës.

## Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta

Viti	Sip. shfrytëzimi Lekë/m <sup>2</sup>	Sipërfaqja totale e ndërtimit	Sipërfaqja e ndërtuar sipas deklarimit	Vlera e ndërtimit
1996	19,581.00		76	1,488,156.00
1997	19,581.00		76	1,488,156.00
1998	27,878.00		9.5	264,841.00
1999	27,878.00		9.5	264,841.00
2000	29,201.00		9.5	277,409.50
2001	32,567.00		9.5	309,386.50
<b>Totali</b>		190		<b>4,092,790.00</b>

### 1.4 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie

1.4.1 Të ardhurat familjare ndër vite, të deklaruara nga subjekti, janë pasqyruar në metodologjinë<sup>12</sup> e përgatitur nga Komisioni.

1.4.2 Të ardhurat e deklaruara nga ushtrimi i profesionit të avokatit pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë, nga data 30.11.1993 – më 22.3.1998, me të ardhura mesatare vjetore 1 000 000 lekë në vit, me shumë të të ardhurave të krijuara 4 000 000 lekë, nuk u konfirmuan nga organet tatimore.

1.4.3 Dhoma Kombëtare e Avokatisë, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 20.6.2019, informoi Komisionin se të dhënat që administrojnë nëpër regjistrat e avokatëve i përkisnin periudhës pas vitit 2000 e në vijim. Gjithashtu, ky institucion informoi se nga të dhënat e administruara në një regjistër që dispononin jo në formën e kërkuar nga ligji, subjekti figuronte si avokat me licencë nr. (\*\*\*)<sup>13</sup>.

1.4.4 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve<sup>14</sup> informoi se subjekti i rivlerësimit nuk figuronte të ishte i regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.

1.4.5 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit<sup>15</sup> në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre të ardhurave, të vërtetuar me dokumentacion.

1.4.6 Në përgjigje të pyetësorit<sup>16</sup> subjekti deklaroi se kishte marrë licencë për ushtrimin e profesionit të avokatit në nëntor të vitin 1993 dhe menjëherë kishte filluar procedurat e regjistrimit si person fizik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, konform legjislacionit të kohës. Në fund të vitit 1993 dhe fillimin e vitit 1994, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ishte vendosur regjistrimi si person fizik, me objekt të veprimtarisë “Avokat”, por nuk dispononte kopje të këtij vendimi. Gjatë kësaj kohe subjekti kishte paguar të gjitha detyrimet që rrjedhin si pasojë e ushtrimit të kësaj veprimtarie, duke përfshirë taksat, tatimet dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Në vijim, subjekti deklaroi se për pagesën e detyrimeve tatimore, verbalisht i ishte thënë se nuk disponoheshin të dhëna për periudhën në fjalë dhe se kishte kërkuar zyrtarisht informacion për secilin, dhe se ishte në pritje të përgjigjes. Pagesat e tatimeve ishin kryer çdo tre muaj në zyrën e tatimeve, por nuk pajisej me mandatin e arkëtimit për shumën që derdhte. Subjekti deklaroi se me sa i kujtohej, rreth vitit 1995 – 1996 ishte trajtuar si biznes i madh.

<sup>12</sup> Referojuni metodologjisë në fund të rezultateve të hetimit (nga f. 56 - 59), në dosjen e Komisionit.

<sup>13</sup> Dhoma Kombëtare e Avokatisë konfirmon se kjo e dhënë është e rezervuar dhe se mund të përdoret vetëm nëse vlerësohet e dobishme për çështjen.

<sup>14</sup> Referojuni shkresës nr. (\*\*\*) prot., datë 8.5.2018, në dosjen e Komisionit.

<sup>15</sup> Referojuni pyetësorit datë 18.6.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>16</sup> Referojuni përgjigjeve datë 21.6.2019, në dosjen e Komisionit.



## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

1.4.7 Së bashku me deklarin e tij, subjekti depozitoi vërtetim nr. (\*\*\*) prot., datë 19.6.2019, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën 1.1.1994 – 31.3.1998, si dhe kërkesë për informacion, datë 20.6.2019, drejtuar DRT-së Tiranë.

1.4.8 Komisionit, nga analizimi i provave, i rezultoi se vërtetimi i depozituar nga subjekti konfirmonte vetëm faktin se ishin paguar kontributet, por pa përcaktuar shumën, megjithëse pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nuk është tregues i nivelit të provueshmërisë mbi të ardhurat e qarkulluara dhe të fituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit.

1.4.9 Edhe ILDKPKI-ja, në lidhje me këtë deklarin të subjektit, ka konstatuar se *nuk konfirmohen nga institucionet e specializuara të ardhurat e deklaruar nga subjekti, realizuar nga aktiviteti tregtar “avokat”, në shumën 4 000 000 lekë.*

1.5 Komisioni kreu analizën financiare për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të shumave të shpenzuara për ndërtimin e kësaj pasurie, duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e përshkruara në pikën 1.4.1 më sipër, për shkak se dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm i krijimit të të ardhurave nga ushtrimi i profesionit të avokatit.

1.6 Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet analiza nga momenti i fillimi të ndërtimit të pasurisë, viti 1996, deri në përfundimin e saj, viti 2001, sikurse subjekti deklaronte.

**Tabela nr. 2**

		<b>1996</b>	<b>1997</b>	<b>1998</b>	<b>1999</b>	<b>2000</b>	<b>2001</b>
<b>1</b>	<b>Pasuri</b>	<b>1,488,156</b>	<b>1,488,156</b>	<b>264,841</b>	<b>264,841</b>	<b>277,410</b>	<b>309,387</b>
	Ndërtimi i shtëpisë	1,488,156	1,488,156	264,841	264,841	277,410	309,387
<b>2</b>	<b>Të ardhura</b>	<b>140,696</b>	<b>180,724</b>	<b>496,173</b>	<b>656,950</b>	<b>717,807</b>	<b>1,143,108</b>
	Të ardhura nga paga, subjekti	49,200	58,920	357,553	482,484	508,934	934,362
	Të ardhura nga paga, bashkëshortja	91,496	121,804	138,620	174,466	208,873	208,746
<b>3</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>112,557</b>	<b>240,000</b>	<b>240,000</b>	<b>240,000</b>	<b>240,000</b>	<b>240,000</b>
	Shpenzime jetike	112,557	240,000	240,000	240,000	240,000	240,000
	<b>Analiza (2-3-1)</b>	<b>-1,460,017</b>	<b>-1,547,432</b>	<b>-8,668</b>	<b>152,109</b>	<b>200,398</b>	<b>593,722</b>

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

1.7 Komisioni, nga analizimi i fakteve dhe rrethanave të përshkruara më sipër për hetimin e kësaj pasurie, si dhe pas kryerjes së përlllogaritjeve financiare, pasqyruar në tabelën nr. 2 më lart, konstatoi dhe, për rrjedhojë, i kaloi subjektit barrën<sup>17</sup> e provës, pasi:

- i. dukej se kishte mospërputhje mes kostos së ndërtimit të deklaruar në deklaratën “Vetting”, me aktin e ekspertimit 2 206 030 lekë, si dhe çmimeve të EKB-së, në vlerën 4 092 790 lekë;
- ii. dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 3 016 117 lekë (sipas përlllogaritjeve të kryera me çmimet e EKB-së) për të investuar në ndërtimin e kësaj pasurie të paluajtshme përgjatë viteve 1996 – 1998, si dhe për të përballuar shpenzimet familjare;
- iii. dukej se nuk provoheshin me dokumentacion justifikues, të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit për periudhën 1993 – 1998;
- iv. dukej se subjekti nuk kishte deklaruar në deklaratën për vitin 2003, ndërtimin me sip. 76 m<sup>2</sup>, pasi në këtë deklaratë ishte deklaruar godinë me sip. 120 m<sup>2</sup>, ndërsa sipas lejes së legalizimit ishte legalizuar godinë trekatëshe me sip. 196 m<sup>2</sup>;
- v. dukej se nuk përputhej deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting”, në lidhje me shumën e shpenzuar për ndërtimin e pasurisë trekatëshe me sip. 196 m<sup>2</sup>, në vlerën 2 200 000 lekë, me deklaratën periodike të vitit 2003, ku ishte deklaruar po kjo vlerë, por sipërfaqja 120 m<sup>2</sup>, (pra, 76 m<sup>2</sup> më pak);
- vi. dukej se kishte mospërputhje në deklarimin e burimit të kësaj pasurie pasi, në deklaratën “Vetting” deklarohet si burim *të ardhura familjare në vite dhe nga të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit për periudhën 1993 – 1998*; në deklaratën për vitin 2003 deklarohet si burim *me kursime familjare*; në deklaratën për vitin 2016 deklarohet si burim *me të ardhurat nga puna si avokat*;
- vii. dukej se ishte kryer deklarim i pasaktë në deklaratën “Vetting” në lidhje me pasqyrimin e trullit mbi të cilin ishte ndërtuar kjo pasuri, se ai ishte tërësisht *pasuri e trashëguar*, ndërsa në pyetësorë u deklarua, sikurse dhe rezultoi gjatë hetimit administrativ dhe nga dokumentacioni i përcjellë nga ZVRPP-ja<sup>18</sup> Tiranë, se një pjesë e tij, me sip. 54.1 m<sup>2</sup>, ishte zënë si pasuri *shtet*.

### **1.8 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni**

- Ndër të tjera, në prapësimet<sup>19</sup> e tij, subjekti ka deklaruar se kosto e ndërtimit të kësaj banese ka qenë rreth shumës 2 200 000 (dy milionë e dyqind mijë) lekë. Kjo shifër ishte e përafërt, pasi nuk dispononte dokumentacionin e nevojshëm për të provuar saktësinë e saj. Nuk janë mbajtur llogari në lidhje me shumën e shpenzuar për ndërtimin e saj, pasi ky ndërtim ka zgjatur për disa vite, në varësi të mundësive financiare që subjekti ka pasur. Në këto kushte, ka kryer një llogaritje të përgjithshme në lidhje me kostot e ndërtimit të saj dhe për këtë arsye kishte dërguar pranë Komisionit raportin e ekspertit vlerësues të pasurive të paluajtshme. Ka kërkuar caktimin e një eksperti të pavarur për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, të zgjedhur nga Shoqata e Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme (apo çdo ekspert tjetër i pavarur i fushës), duke shprehur gatishmërinë të parapaguante të gjitha kostot e këtij ekspertimi, me njoftimin më të parë që mund t'i bëhej nga Komisioni.

- Për sa i përket të ardhurave nga puna si avokat, subjekti i kishte kërkuar organeve tatimore të nxirrnin të gjitha të dhënat në lidhje me pagesat e detyrimeve tatimore, apo nëse të dhënat

<sup>17</sup> Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, referoni rezultatet për specifikimet në detaje.

<sup>18</sup> Referojuni shkresës nr. (\*\*\*) prot., datë 20.5.2018, dhe të gjithë dokumentacionit bashkëngjitur (më konkretisht, nga f. 136 e në vijim, 160 e në vijim), në dosjen e Komisionit.

<sup>19</sup> Referojuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit.

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

nuk ekzistonin, të sqaroheshin arsyet e mungesës së tyre, të tilla si, mosregjistrimi në organet tatimore, mospagesa e detyrimeve tatimore, për të cilat nuk ishte sqaruar arsyeja e mungesës së të dhënave në fjalë nga institucioni i tatimeve. Tatimi vjetor ishte llogaritur nga inspektorët e organeve tatimore brenda çdo muaji janar, për çdo vit tatimor, mbështetur në deklaratën vjetore parashikuese. Pagesën e tatimfitimit të thjeshtuar, ose tatimin mbi të ardhurat, i kishte derdhur në katër këste në 15 mars, 15 qershor, 15 shtator dhe 30 nëntor të çdo viti që kishte ushtruar aktivitetin e avokatit. Me mbylljen e aktivitetit kishte dorëzuar çdo lloj dokumentacioni në organet tatimore dhe konkretisht, dokumentacionin që përcaktonte kodin fiskal ku kryhej pagesa e kësteve të tatimfitimit të thjeshtuar. Çdo biznes ka dosjen e tij dhe ruhet në arkiv edhe kur ai nuk e ushtron më aktivitetin. Kartoni që ka të shënuar kodin fiskal, i cili është kod që evidenton subjektin, në momentin që ai nuk e ushtron aktivitetin e dorëzon në zyrën e protokollit ose inspektorit që e ka mbuluar si subjekt në atë periudhë. Sipas subjektit, përgjigjja e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, se në emrin e tij si tatimpagues nuk ka asnjë të dhënë, nuk qëndronte, pasi ai kishte qenë subjekt i tatimfitimit të thjeshtuar dhe i sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Në kushtet kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjej brenda afatit ligjor, nuk kishte mundësi tjetër për të vërtetuar të dhënat e kërkuara prej Komisionit.

- Për sa i përkonte mosdeklarimit të sipërfaqes prej 76 m<sup>2</sup>, subjekti ka shpjeguar se deklarimi i tij në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, i referohej vetëm sipërfaqes së banimit, pasi papafingo nuk përdorej për banim. Gjithashtu, edhe sipërfaqja 120 m<sup>2</sup> i referohej sipërfaqes së matur brenda mureve (sipërfaqe e shfrytëzueshme), pasi në atë kohë kjo banesë nuk ishte e pajisur me certifikatë pronësie. Me mbylljen e procesit të legalizimit dhe pajisjen me certifikatë pronësie, rezultoi sipërfaqja 190 m<sup>2</sup>, ku përfshihej sipërfaqja e ndërtimit (jo vetëm sipërfaqja e shfrytëzimit), si dhe papafingo që sipas vlerësimit të ekspertëve të ALUZNI-it u konsiderua sipërfaqe e regjistrueshme.

- Për sa i përkonte deklarimit në lidhje me truallin (sipërfaqja shtet 54.1 m<sup>2</sup>) mbi të cilin ishte ndërtuar kjo pasuri, subjekti depozitoi vendimin e gjykatës nr. (\*\*\*) datë 26.3.2016, si dhe vendimin nr. (\*\*\*) datë 15.5.1996, të Komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave.

### **1.9 Vlerësimi i Komisionit**

- Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në raport me shpjegimet e subjektit, në lidhje me vlerën e kostove të ndërtimit dhe burimet e ligjshme të përdorura për këtë pasuri, në analizë të provave në raport me faktet e konstatuara, arsyeton:

1.9.1 Nisur nga mospërputhjet e deklarimeve të subjektit mbi kostot e ndërtimit në raport me sipërfaqet e deklaruara në deklaratën periodike dhe atë “Vetting”, rezultoi se subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore këtë pasuri me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup>, në vlerën 2.2 milionë lekë dhe në deklaratën “Vetting” deklaroi po këtë vlerë, por për një sipërfaqe më të madhe prej 196 m<sup>2</sup>. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar shtesën me sip. 76 m<sup>2</sup> që në deklaratën periodike të vitit 2003, ku sipas formularit të plotësuar për legalizimin e kësaj godine banimi<sup>20</sup> nga subjekti rezultonte e deklaruar se godina trekatëshe ishte ndërtuar në vitin 1996. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion (të tilla si situacion, fatura preventive) vlerën reale të ndërtimit, sikurse është parashikuar në udhëzimin nr. (\*\*\*) prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim, përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare, etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 datë 30.8.2016”, pika 26 e tij.

<sup>20</sup> Referojuni praktikës nr. (\*\*\*) prot., datë 22.5.2018, ardhur nga ALUIZNI, në dosjen e Komisionit.

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

Pretendimin e subjektit se nuk e ka deklaruar sipërfaqen 76 m<sup>2</sup>, pasi deklarimi i tij në deklaratën periodike për vitin 2003, i referohej vetëm sipërfaqes së banimit dhe se papafingo nuk përdorej për banim, trupi gjykues e vlerëson se ai bie në kundërshtim me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, pasi duhej të kishte deklaruar të gjithë sipërfaqen e kësaj pasurie, siç edhe vërtetohet nga dokumentacioni i depozituar nga ALUIZNI, në formularin e vetëdeklarimit të subjektit. Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave, trupi gjykues çmon se deklarimi i vlerës së ndërtimit të kësaj pasurie nuk është vlera reale e saj. Trupi gjykues arrin në këtë përfundim, për sa kohë që edhe akti i ekspertimit të kryer nga eksperti (i licencuar) i zgjedhur prej tij, nuk bazohej në referenca ligjore, metodologji, apo standarde zyrtare të njohura në rastet e ndërtimeve edhe me kosto më të ulët të cilat ekzistonin edhe në kohën e ndërtimit të kësaj pasurie, pavarësisht se aktet nënligjore mund të jenë miratuar edhe pas vitit 1996, por ato kanë shtrirë efektet e tyre që prej vitit 1996, kohë në të cilën subjekti ka vetëdeklaruar ndërtimin e pasurisë.

Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave, është bazuar në kostot mesatare vjetore të shfrytëzimit, sipas përcaktimeve në vendimet dhe udhëzimet e Entit Kombëtar të Banesave, të cilat në parashikimet e tyre kanë përfshirë edhe vlerën e kostove për vitet 1996 – 2001, siç pasqyrohen në tabelën nr. 1. Në këto përlllogaritje janë mbajtur në konsideratë sipërfaqet e ndryshme të ndërtuara për secilin vit, sipas deklarimit të subjektit, të cilat, duke u shumëzuar me koston mesatare të shfrytëzimit sipas EKB-së, japin vlerën totale të ndërtimit.

Duke vlerësuar faktet dhe rrethanat e arsyetuara më lart, pas përlllogaritjeve të kryera, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka deklaruar vlerën reale të kostove të ndërtimit të kësaj pasurie, si dhe nuk ka pasur aftësi financiare në shumën 3 016 117 lekë (sipas përlllogaritjeve të kryera me çmimet e EKB-së) për të investuar në ndërtimin e kësaj pasurie të paluajshme përgjatë viteve 1996 – 1998, si dhe për të përballuar shpenzimet familjare.

1.9.2 Lidhur me burimet e ligjshme të të ardhurave nga ushtrimi i profesionit të avokatit për periudhën 1993 – 1998, që ndikonte në pamundësinë financiare, siç pasqyrohet në tabelën nr. 2, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka konfirmuar faktin se subjekti nuk ka qenë i regjistruar si subjekt tatimor. Nga ana tjetër, trupi gjykues konstaton se pretendimet e subjektit për pagesa të detyrimeve tatimore, apo për pamundësi të të dhënave nga institucioni i Drejtorisë Tatimore mbetën thjesht dhe vetëm në kuadër deklarativ, si dhe bien në kundërshtim me konfirmimin e institucionit tatimor, si një subjekt i paregjistruar. Nën këtë arsyetim, trupi gjykues çmon se nuk qëndron as pretendimi i subjektit se në kushtet kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjej brenda afatit ligjor, nuk kishte mundësi tjetër për të vërtetuar, pasi ky institucion i kishte kthyer përgjigje Komisionit dhe subjekti i rivlerësimit ishte njohur me të nga aktet në dosje.

Trupi gjykues bën këtë vlerësim për sa kohë që edhe subjekti i rivlerësimit nuk depozitoi ndonjë dokumentacion që i përkiste regjistrimit apo çregjistrimit të ushtrimit të aktivitetit si avokat, si dhe nga ana e tij nuk u shpjeguan mospërputhjet e deklarimit të burimit të kësaj pasurie, në deklaratën periodike të vitit 2003, 2016 dhe atë “Vetting”.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues çmon se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor burimet e ligjshme për ndërtimin e kësaj pasurie.

1.9.3 Lidhur me deklarimin e truallit, trupi gjykues, duke pasur parasysh faktet dhe provat se: (i) sipërfaqja e zënë prej 54 m<sup>2</sup>, ishte pasuri *shtet*, (ii) vendimi i KKKP-së<sup>21</sup>, i depozituar nga subjekti, daton në vitin 1996 (përpara blerjes së kësaj sipërfaqeje), me të cilin subjekti synon

<sup>21</sup> Referojuni vendimit nr. (\*\*\*) , datë 15.4.1996, të KKKP-së ish-pronarëve, depozituar nga subjekti në prapësimet e tij.

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

që të provojë indirekt se edhe kjo sipërfaqe ka qenë e tij, pavarësisht se ai e ka blerë si kalim të parcelës ndërtimore nga ALUIZNI në favor të tij, (iii) vendimi gjyqësor i depozituar, me të cilin përsëri subjekti kërkon që të provojë indirekt të njëjtën pretendim, çmon se fakti i blerjes së kësaj pasurie nga shteti si pasuri e këtij të fundit, nuk le vend për të vlerësuar mbi provueshmërinë e provave të depozituara nga subjekti, si dhe për t'i marrë ato në konsideratë dhe, për pasojë, konstatohet se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën për "Vetting", në lidhje me pasqyrimin e truallit mbi të cilin ishte ndërtuar kjo pasuri, se ai ishte tërësisht *pasuri e trashëguar*.

**Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, bazuar** në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, deklaramet e subjekti gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i. subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me vlerën reale të kostove të ndërtimit;
- ii. nuk ka pasur aftësi financiare në shumën 3 016 117 lekë (sipas përlllogaritjeve të kryera me çmimet e EKB-së) për të investuar në ndërtimin e kësaj pasurie të paluajtshme përgjatë viteve 1996 – 1998, si dhe për të përballuar shpenzimet familjare;
- iii. nuk ka provuar me dokumentacion ligjor burimet e ligjshme nga ushtrimi i profesionit të avokatit;
- iv. ka kryer deklaram të pasaktë të përfitimit të pasurinë truall, dhe për rrjedhojë çmon se subjekti nuk ka deklaruar vlerën reale të ndërtimit dhe nuk ka provuar burimin e ligjshëm të tyre, sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

**2. Në lidhje me shtëpi banimi dykatëshe**, me sip. 120 m<sup>2</sup>. Kati i parë me sip. 60 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie (\*\*\*) , është ndërtuar në vitin 1960 nga babai i subjektit, kati i dytë me sip. 60 m<sup>2</sup> (pjesa ime takuese prej 1/3) është ndërtuar nga subjekti gjatë viteve 2006 – 2011, në shumën 11 000 000 lekë (njëmbëdhjetë milionë lekë). Kjo shtesë është futur në proces legalizimi në datën 10.1.2017. Pjesa takuese: 50% me bashkëshorten. **Burimi i deklaruar i krijimit:** Të ardhurat familjare ndër vite.

Subjekti ka deklaruar në deklaratën "Vetting": *\*Të dy pasuritë më sipër (ka sqaruar në deklaratën "Vetting" subjekti) janë të ndërtuara në të njëjtin truall prej 550 m<sup>2</sup>, të trashëguar nga babai im.*

2.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë ka konstatuar: *Mosdeklaram nga ana e subjektit në deklaratat e interesave private periodike/vjetore 2006 – 2011, e shtesës së katit të ndërtuar mbi objektin ekzistues, deklaruar me sip. 60 m<sup>2</sup> dhe mosparaqitje e dokumentacionit justifikues ligjor, si situacion dhe preventiv punimesh, lidhur me shpenzimet e kryera për ndërtimin e shtesës së katit mbi objektin e mësipërm.*

2.2 Edhe nga hetimi administrativ Komisionit i rezultoi se subjekti nuk e kishte deklaruar në deklaratat periodike të viteve 2006 – 2011 shtesën e katit të ndërtuar mbi objektin ekzistues, shtesë kjo që i përket pasurisë së deklaruar në deklaratën "Vetting", me përshkrimin "*shtëpi banimi 2-katëshe me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup>*".

2.3 Gjatë hetimit administrativ rezultoi se subjekti e kishte deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2003 me përshkrimin "*shtëpi banimi, sipërfaqja 60 m<sup>2</sup>, me burim krijimi - trashëgimi*".

2.4 ZVRPP-ja në praktikën e saj e ka konfirmuar këtë pasuri si të trashëguar nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, e ndërtuar prej vitit 1960, gjithashtu në truall të trashëguar me sipërfaqe 550 m<sup>2</sup>, prej të cilit subjekti zotëron 1/3 pjesë takuese, pasi pjesa tjetër, sipas aktit të

## Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta

pjesëtimit, i ka takuar vëllait dhe motrës së tij. Origjina e përfitimit të kësaj pasurie, nga një truall dhe ndërtim në 1/3 pjesë takuese, i trashëguar prej vitit 1960, i ndarë nga trashëgimtarët me kontratë pjesëtimi, etj., është sqaruar dhe arsyetuar gjerësisht në pasurinë e parë.

2.5 Mbi këtë pasuri subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” shtesën e katit të dytë të ndërtuar prej vitit 2006 – 2011, si pasuri e cila ndodhej në procedurë legalizimi.

2.6 Nga hetimi i Komisionit për këtë pasuri, sipas informacionit të dhënë nga ALUIZNI<sup>22</sup>, u konfirmua se ishte ende në procedurë legalizimi. Më konkretisht, ky institucion ka informuar se subjekti i rivlerësimit është subjekt i ligjit nr. 9482/2006, me anë të deklaratës për legalizim me nr. (\*\*\*) prot., viti 2017, për shtesë në lartësi në ndërtim me leje, me adresë Rr. “(\*\*\*)”, nr. (\*\*\*), Tiranë dhe se kjo praktikë është në trajtim e sipër.

2.7 Sipas deklaratës së subjektit në praktikën e ALUIZNI-t, rezultoi se ndërtimi është kryer në vitin 2009 – 2010 dhe jo prej vitit 2006 – 2011, sikurse ai ka deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe në pyetësor. Ndërsa, sipas aktit të ekspertimit të dorëzuar nga subjekti thuhej se objekti është ndërtuar gjatë viteve 2008 – 2011.

2.8 Për shkak të mospërputhjeve mes deklaratës periodike vjetore të vitit 2003 dhe asaj “Vetting”, Komisioni e ka pyetur subjektin për këtë pasuri, por edhe për kostot e ndërtimit për secilin vit.

2.9 Në sqarimet<sup>23</sup> e tij, subjekti ka konfirmuar se sipërfaqja është **79.3 m<sup>2</sup>**, duke dorëzuar edhe një aktektperelize teknike në lidhje me shpenzimin total të ndërtimit. Nga verifikimi i aktit, Komisionit i rezultoi se vlera e paraqitur ndryshonte nga ajo e deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”. Gjithashtu, po nga verifikimi i aktit të ekspertimit u konstatua se eksperti në raportin e tij, sikurse edhe në pasurinë e parë, kishte qartësuar se mënyra e përlllogaritjes përmban një opinion të pabazuar në legjislacion, por të përafërt me tregun informal të ndërtimit.

2.10 Duke qenë se rezultonin dy vlera ndërtimi kontradiktore për këtë pasuri, mes deklarimit të subjektit (11 000 000 lekë) dhe aktit të ekspertimit (1 124 935 lekë), Komisioni e ka pyetur<sup>24</sup> subjektin, pasi ai më parë saktësonte se vlera 11 000 000 lekë, e deklaruar në deklaratën “Vetting”, *përbënte një lapsus* dhe se vlera e ndërtimit ka qenë rreth 1,100,000 lekë. Por Komisionit i rezultoi se edhe kjo e fundit (vlera 1 100 000 lekë) nuk përkonte me atë të rezultuar nga akti i ekspertimit. Komisionit, sikurse në pasurinë e parë, i rezultoi se edhe për këtë pasuri, fillimisht subjekti nuk kishte dhënë informacion për kostot e ndërtimit për secilin vit.

2.11 Subjekti, në përgjigjet<sup>25</sup> e tij, ka deklaruar se gjatë dy viteve të para është kryer rreth 60 % e shpenzimeve të ndërtimit (vitet 2006 – 2007), rreth 20% në vitin 2008 dhe pjesa tjetër e ndarë në mënyrë të barabartë në vitet 2009 – 2011.

2.12 Komisioni kreu analizën për të nxjerrë koston e ndërtimit duke u bazuar në koston mesatare vjetore të shfrytëzimit nga Enti Kombëtar i Banesave<sup>26</sup>.

**Tabela nr. 3**

Viti	Sip. shfrytëzimi Lekë/m <sup>2</sup>	Sipërfaqja totale e ndërtimit	Sipërfaqja e ndërtuar sipas deklarimit	Vlera e ndërtimit
------	---	-------------------------------------	--	-------------------

<sup>22</sup> Referojuni praktikës nr. (\*\*\*) prot., datë 25.5.2018, ardhur nga ALUIZNI, në dosjen e Komisionit. Në këtë praktikë konfirmohet vetëm legalizimi i pasurisë nr. 1 të përshkruar në këto rezultate.

<sup>23</sup> Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 6.5.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>24</sup> Pyetje datë 5.6.2019.

<sup>25</sup> Pyetësor nr. 3, datë 27.5.2019.

<sup>26</sup> Udhëzim nr. 5, datë 7.9.2006; udhëzim nr. 2, datë 4.4.2007; udhëzim nr. 1, datë 20.8.2008; udhëzim nr. 3, datë 3.2.2010; udhëzim nr. 4, datë 23.11.2011. Në të gjitha udhëzimet është marrë kosto mesatare për sipërfaqe shfrytëzimi në qytetin e Tiranës.

**Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta**

2006	28,860.00		23.79	686,579.40
2007	29,914.00		23.79	711,654.06
2008	33,174.00		15.86	526,139.64
2009	33,174.00		5.29	175,379.88
2010	34,260.00		5.29	181,121.20
2011	36,427.00		5.29	192,577.41
<b>Totali</b>		<b>79.3</b>		<b>2,473,451.59</b>

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet analiza nga momenti i fillimi të ndërtimit, viti 2006, deri në përfundimin e saj, viti 2011.

**Tabela nr.4**

	<b>Përshkrimi</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>
<b>1</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>1,746,032</b>	<b>2,332,284</b>	<b>2,049,799</b>	<b>2,685,321</b>	<b>3,189,114</b>	<b>3,652,388</b>
	Të ardhura nga paga, subjekti	1,574,230	1,642,375	1,807,319	1,835,562	1,932,514	1,779,791
	Të ardhura nga paga, bashkëshortja	171,802	189,909	242,480	849,759	945,213	1,128,339
	Të ardhura nga paga, djali	-	-	-	-	311,387	744,258
	Të ardhura nga shitja e autoveturës "Landrover" TR (***)	-	500,000	-	-	-	-
<b>2</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>865,932</b>	<b>1,342,840</b>	<b>898,312</b>	<b>1,060,199</b>	<b>311,966</b>	<b>1,192,227</b>
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	438,228	943,872	546,480	546,480	546,480	546,480
	Kredia në "NBG" (10.205 euro) (principal + interes)	345,614	398,968	344,497	460,772	-	-
	Kredia në "Credins", bashkëshortja (korrik 2010) 500 000 lekë (principal + interes)	-	-	-	-	(409,619)	216,914
	Kredia në "Credins", djali (11.2.2011) 400.000 lekë (principal + interes)	-	-	-	-	-	(200,304)
	Shpenzime shkollimi/Master, vajza	-	-	-	-	30,000	30,000
	Shpenzime TIMS	82,091	-	7,335	52,947	145,105	299,136
	Shpenzime arredimi shitesa, kati i dytë (79.3 m <sup>2</sup> )	-	-	-	-	-	300,000
<b>3</b>	<b>PASURI</b>	<b>1,146,237</b>	<b>387,641</b>	<b>393,293</b>	<b>211,968</b>	<b>608,180</b>	<b>1,017,559</b>

## *Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta*

<b>Pasuri e paluajtshme/e luajtshme</b>						
Shtëpi banimi 2-kate 120m <sup>2</sup> , Rr. “(***)” (trashëgimi)	686,579	711,654	526,140	175,380	181,121	192,577
Automjet “Smart” AA (***) , blerë në 2011	-	-	-	-	-	691,500
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	459,657	(324,013)	(132,847)	(387,348)	427,059	133,482
<b>DIFERENCA (1-2-3)</b>	<b>-266,137</b>	<b>601,803</b>	<b>758,193</b>	<b>1,837,091</b>	<b>2,268,968</b>	<b>1,442,602</b>

Komisioni, nga analizimi i fakteve dhe rrethanave, të përshkruara më sipër për hetimin e kësaj pasurie, si dhe pas kryerjes së përlogaritjeve financiare, pasqyruar në tabelën nr. 4 më lart, konstatoi dhe, për rrjedhojë, i kaloi subjektit barrën<sup>27</sup> e provës, pasi:

- i. dukej se kishte mospërputhje mes kostos së ndërtimit të shtesës mbi pasurinë e trashëguar, të deklaruar nga subjekti në pyetësor, në vlerën 1 100 000 lekë, me aktin e ekspertimit në vlerën 1 124 935 lekë dhe vlerën e rezultuar sipas çmimeve të EKB-së, 2 473 452 lekë;
- ii. dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 266 137 lekë për të investuar në ndërtimin e kësaj pasurie të paluajtshme gjatë vitit 2006, si dhe për të përballuar shpenzimet familjare;
- iii. dukej se kishte mospërputhje në deklaratimet e subjektit në deklaratën “Vetting” dhe pyetësorë, kur deklaronte se këtë ndërtim e kishte kryer në vitet 2006 – 2011 dhe deklaratimit të bërë pranë ALUIZNI-t, se këtë ndërtim e kishte kryer në vitet 2009 – 2010, si dhe nga pasqyrimi i ekspertit në aktin e ekspertimit, ku qartësohej se ky ndërtim është realizuar në vitet 2008 – 2011;
- iv. dukej se nuk kishte deklaruar në deklaratat përkatëse periodike, katin shtesë të ndërtuar në këtë pasuri prej vitit 2006 – 2011 dhe, për pasojë, edhe burimin e krijimit të shumës së shpenzuar për ndërtimin e tij;
- v. dukej se kishte vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar, pasi nuk kishte deklaruar shpenzimet e kryera për ndërtimin e shtesës, sipas çmimeve të EKB-së, përkatësisht, në vitin 2006 në shumën 686 579.40 lekë, në vitin 2007 në shumën 711 654.06 lekë dhe në vitin 2008 në shumën 526 139.64 lekë, shuma të cilat e kanë tejkaluar vlerën 500 000 lekë, sikurse parashikohej në deklaratat e pasurisë deri në vitin 2014,

si dhe i kërkoi shpjegime, pasi:

- i. dukej se deklarimi i subjektit për shtesën mbi një ndërtim të viteve ‘60, periudhë kohore relativisht e gjatë për të dhënë mundësinë e ndërtimit të saj/shtesës mbi të, nuk ishte bindës, për më tepër kur deklaronte në deklaratën “Vetting” shumën 11 000 000 lekë, madje edhe me fjalë, me deklarimin e tij në pyetësorë, se kjo shumë është 1 100 000 lekë.

### **2.13 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni**

Në lidhje me këtë pasuri subjekti ka sqaruar se deklarimi i bërë pranë ALUIZNI-t i referohet periudhës në të cilën ky ndërtim mund të konsiderohej i banueshëm, edhe pse punime të

<sup>27</sup> Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, refero rezultatet për specifikimet në detaje.



## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

ndryshme kanë vazhduar deri në vitin 2011. Gjithashtu, në momentin e deklarimit i është kërkuar nga punonjësit e ALUIZNI-t, përcaktimi i një periudhe kohore sa më të kufizuar.

Për sa i përket kostos së ndërtimit subjekti ka theksuar se ky ndërtim është realizuar mbi një ndërtim ekzistues. Madje, njëra nga faqet e murit është e përbashkët me atë të shtëpisë së vëllait, i cili e ka ndërtuar nga e para shtëpinë e tij. Në koston e tij nuk mund të përfshihen edhe kostot e ndërtimit të themeleve, të cilat përfshihen në çmimet e EKB-së të marra si referencë nga Komisioni për vlerësimin e kostos së ndërtimit të kësaj shtese. Sipas konsultimeve me specialistë të fushës, kosto e ndërtimit të themeleve në një ndërtim të ngjashëm zë minimalisht 23% të vlerës së ndërtimit. Ndodhur në këto kushte, sikurse edhe për banesën tjetër, subjekti ka kërkuar caktimin e një eksperti të pavarur për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, të zgjedhur nga Shoqata e Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme (apo çdo ekspert tjetër të pavarur të fushës), duke sqaruar se është i gatshëm të parapaguajë të gjitha kostot e këtij ekspertimi, me njoftimin më të parë. Gjithashtu, subjekti ka theksuar se kati shtesë mbi shtëpinë është ndërtuar prej tij gjatë viteve 2006 – 2011, se ky ndërtim është shtrirë në kohë sipas mundësive financiare që ka pasur, si dhe nga fakti që kjo shtesë nuk pengonte funksionimin normal të katit të parë të shtëpisë ekzistuese. Deklarimi në deklaratën “Vetting” i shumës 11 000 000 lekë, është qartazi lapsus, pasi ndërtimi i një shtese kati me këtë sipërfaqe nuk mund të arrijë atë vlerë, pavarësisht metodologjisë së llogaritjes së kostove të ndërtimit.

### **2.14 Vlerësimi i Komisionit**

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në raport me shpjegimet e subjektit, në lidhje me vlerën e kostove të ndërtimit dhe burimet e ligjshme të përdorura për këtë pasuri, në analizë të provave në raport me faktet e konstatuara, arsyeton:

2.14.1 Nisur nga mospërputhjet mes kostos së ndërtimit të shtesës mbi pasurinë e trashëguar, të deklaruar nga subjekti në pyetësor në vlerën 1 100 000 lekë, me aktin e ekspertimit në vlerën *1 124 935 lekë* dhe vlerën e rezultuar sipas çmimeve të EKB-së, *2 473 452 lekë*, për të cilën subjekti ka pretenduar se ajo është ndërtuar mbi një ndërtim ekzistues, subjekti nuk provoi me dokumentacion justifikues shpenzimin e pretenduar për ndërtimin e shtesës. Edhe në këtë rast trupi gjykues, për një vlerësim të drejtë dhe objektiv, për shkak edhe të pretendimeve të subjektit të cilat mbetën në nivel deklarativ, mori në konsideratë çmimet e Entit Kombëtar të Banesave, referuar gjithnjë akteve nënligjore të cituara në pasurinë e parë, për të konkluduar në shpenzimin real të bërë për ndërtimin e shtesës 79.3 m<sup>2</sup>, sipërfaqe kjo e deklaruar nga subjekti në pyetësor, në ndryshim nga deklarimi i bërë në deklaratën “Vetting” dhe atë periodike të vitit 2003.

Pretendimi i subjektit se, në kostot e përlllogaritura, vlera e themeleve zë një përqindje të lartë e cila nuk duhet konsideruar pasi ndërtimi është shtesë mbi një ndërtim të mëparshëm, nuk qëndron, për vetë faktin se, edhe nëse do të merrej i mirëqenë, atëherë kostot e përlllogaritura nga Komisioni sipas standardit të EKB-së do të ishin jo minimaliste, por për ndërtime të cilat kërkojnë shpenzime ekstra, për shkak të mbrojtjes së qëndrueshme që duhet të kenë si të ngritura mbi ndërtime tepër të hershme. Gjithashtu, një pretendim i tillë nuk ka qenë i pasqyruar apo reflektuar në aktin e ekspertimit që vetë subjekti ka depozituar.

Edhe për vlerësimin e kësaj pasurie/shtesë, trupi gjykues, pas vlerësimit të fakteve dhe rrethanave, është bazuar në kostot mesatare vjetore të shfrytëzimit, sipas përcaktimeve në vendimet dhe udhëzimet e Entit Kombëtar të Banesave, të cilat në parashikimet e tyre kanë përfshirë edhe vlerën e kostove për vitet 2006 – 2011, siç pasqyrohen në tabelën nr. 3. Në këto përlllogaritje janë mbajtur në konsideratë sipërfaqet e ndryshme të ndërtuara për secilin vit, sipas deklarimit të subjektit, të cilat duke u shumëzuar me koston mesatare të shfrytëzimit sipas EKB-së, japin vlerën totale të ndërtimit.

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

Trupi gjykues, sikurse ka arsyetuar në pasurinë e parë, edhe për këtë pasuri, në vlerësim të fakteve e rrethanave, çmon se deklarimi i vlerës së ndërtimit të pasurisë shtesë nuk është vlera reale e saj. Trupi gjykues arrin në këtë përfundim për sa kohë që edhe akti i ekspertimit të kryer nga eksperti (i licencuar) i zgjedhur prej tij, nuk bazohej në referenca ligjore, metodologji, apo standarde zyrtare të njohura në rastet e ndërtimeve.

Duke vlerësuar faktet dhe rrethanat e arsyetuara më lart, pas përlogaritjeve të kryera, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka deklaruar vlerën reale të kostove të ndërtimit të kësaj pasurie, si dhe nuk ka pasur aftësi financiare në shumën *266 137 lekë* (sipas përlogaritjeve të kryera me çmimet e EKB-së) për të investuar në ndërtimin e kësaj pasurie të paluajtshme gjatë viteve 2006 - 2011, si dhe për të përballuar shpenzimet familjare.

2.14.2 Lidhur me burimet e ligjshme të shpenzuara për ndërtimin e pasurisë shtesë, të deklaruar nga subjekti si kursime familjare në vite, subjekti nuk arriti të provojë në prapësimet e tij me dokumentacion justifikues, shpenzimin e pretenduar për ndërtimin e shtesës dhe, për pasojë, analiza financiare e Komisionit, e cila ka përfshirë kostot e ndërtimit të përdorura nga standardet e EKB-së, së bashku me përlogaritjet e të ardhurave dhe shpenzimet sipas treguesve në tabelën nr. 4, mbeti e pandryshuar.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues çmon se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor burimet e ligjshme për ndërtimin e kësaj pasurie.

2.14.3 Në lidhje me mospërputhjet e deklarimeve të subjektit në deklaratën “Vetting” dhe pyetësorë, kur deklaronte se këtë ndërtim e kishte kryer në vitet 2006 – 2011, deklarimit të bërë pranë ALUIZNI-t se këtë ndërtim e kishte kryer në vitet 2009 – 2010, si dhe nga pasqyrimi i ekspertit në aktin e ekspertimit ku qartësohej se ky ndërtim është realizuar në vitet 2008 – 2011, subjekti ka pretenduar se në momentin e deklarimit i është kërkuar nga punonjësit e ALUIZNI-t, përcaktimi i një periudhe kohore sa më të kufizuar. Trupi gjykues, edhe duke marrë në konsideratë këtë pretendim, vlerëson përsëri se ka kontradiktë në vitet e ndërtimit të kësaj pasurie midis vetë deklarimit të subjektit në deklaratën “Vetting” dhe aktit të ekspertimit, ku thuhet se ndërtimi është kryer në vitet 2008 – 2011.

- ✓ Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në lidhje me kohën e ndërtimit të kësaj pasurie.

Me gjithë këtë konkluzion analiza financiare është kryer duke konsideruar shpenzimet e bëra për ndërtimin e kësaj pasurie, sikundër ka deklaruar subjekti se ajo është realizuar e shtrirë në kohë prej vitit 2006 – 2011.

2.14.4 Në lidhje me faktin se subjekti nuk kishte deklaruar në deklaratat përkatëse periodike, katin shtesë të ndërtuar në këtë pasuri prej vitit 2006 – 2011 dhe për pasojë edhe burimin e krijimit të shumës së shpenzuar për ndërtimin e saj, trupi gjykues vëren se subjekti në prapësimet e tij nuk është shprehur për këtë konstatim, dhe për rrjedhojë nuk provoi të kundërtën e rezultatit të hetimit, çka çon trupin gjykues në konkluzion se subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm në deklaratat periodike lidhur me ndërtimin e kësaj pasurie dhe shpenzimet e kryera për të.

2.14.5 Në lidhje me faktin se subjekti ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar, pasi nuk kishte deklaruar shpenzimet e kryera për ndërtimin e shtesës, sipas çmimeve të EKB-së, përkatësisht në vitin 2006 në shumën 686 579.40 lekë, në vitin 2007 në shumën 711 654.06 lekë dhe në vitin 2008 në shumën 526 139.64 lekë, shuma të cilat e kanë tejkaluar vlerën 500 000 lekë, sikurse parashikohej në deklaratat e pasurisë deri në vitin 2014, subjekti nuk rezulton të jetë shprehur në prapësime. Trupi gjykues, në analizë të sa më sipër, kur në asnjë rast nuk u provua me dokumentacion justifikues shpenzimi i kryer për realizimin e këtij ndërtimi, kur vlerësimi i kostove është bërë mbi referenca ligjore dhe jo në nivel

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

deklarativ, çmon se shumat e shpenzuara për ndërtimin e pasurisë shtesë të pasqyruara ekzaktësisht në vitet 2006, 2007 dhe 2008, duhet të ishin deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat përkatëse periodike.

- ✓ Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzion se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me pasqyrimin e shpenzimeve të kryera për ndërtimin e kësaj pasurie, në deklaratat për vitet 2006, 2007 dhe 2008 dhe për pasojë ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003.

**Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, bazuar** në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, deklaramet e subjekti gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i. subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me vlerën reale të kostove të ndërtimit;
- ii. nuk ka pasur aftësi financiare në shumën 266 137 lekë (sipas përlllogaritjeve të kryera me çmimet e EKB-së) për të investuar në ndërtimin e kësaj pasurie të paluajtshme përgjatë viteve 1996 – 1998, si dhe për të përballuar shpenzimet familjare;
- iii. ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me kohën e ndërtimit të kësaj pasurie;
- iv. ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003, pasi nuk ka deklaruar shpenzime mbi 500 000 lekë, të bëra në vitet 2006, 2007 dhe 2008 për ndërtimin e kësaj pasurie,

dhe për rrjedhojë çmon se subjekti nuk ka deklaruar vlerën reale të ndërtimit, si dhe ka mungesë financiare të të ardhurave për ndërtimin e saj, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

**3. Në lidhje me gjendje *cash* në lekë,** në shumën 500 000 lekë, në pjesë takuese secili prej bashkëshortëve nga 50%. **Burimi i deklaruar i krijimit:** Të ardhura familjare ndër vite.

3.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë është shprehur: *Të ardhurat familjare janë të mjaftueshme dhe justifikojnë gjendjen cash të deklaruar.*

**4. Në lidhje me gjendje *cash* 5 000 euro,** në pjesë takuese secili prej bashkëshortëve nga 50%. **Burimi i deklaruar i krijimit:** Të ardhura familjare ndër vite.

4.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë është shprehur: *Të ardhurat familjare janë të mjaftueshme dhe justifikojnë gjendjen cash të deklaruar.*

4.2 Gjatë hetimit administrativ Komisionit i rezultoi se subjekti në deklaratat periodike për vitin 2010, 2011, 2013, 2014 dhe 2015, kishte deklaruar gjendje *cash*, me burim *kursime nga pagat, gjendje të cilat dukeshin sikur deklaroheshin të mbivendosura apo të përsëritura në të njëjtën shumë nga viti në vit, madje duke cituar në vitin pasardhës të njëjtin deklaram të vitit paraardhës.*

4.3 Komisioni e ka pyetur<sup>28</sup> subjektin në lidhje me këto paqartësi, për të cilët ka deklaruar se... *shumat e deklaruara gjatë viteve për të cilat është pyetur, i referohen gjendjes totale të shumës cash që kanë mbajtur në banesë. Pra, këto shuma, është shprehur subjekti, nuk pasqyrojnë kursimet e secilit prej viteve të deklaruara, por ka qenë shuma totale kumulative e kursyer deri në vitin e deklaruar.*

4.4 Komisionit, nisur nga:

- a) deklarimi i lartpërmendur i subjektit;
- b) deklarimi në deklaratën periodike të vitit 2015, ku ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 150 000 lekë;

<sup>28</sup> Referojuni pyetësorit nr. 2, datë 6.5.2019, në dosjen e Komisionit.

## **Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta**

- c) deklarimi në deklaratën periodike të vitit 2016, ku nuk ka deklaruar gjendje *cash*;
- d) deklarimi në deklaratën “Vetting”, ku ka deklaruar *cash* shumat 500 000 lekë dhe 5 000 euro;
- e) të ardhurat nga 31.12.2016 – më 30.01.2017, kur është plotësuar deklarata “Vetting”, të cilat kanë qenë vetëm pagat e subjektit dhe bashkëshortes së tij, në total në shumën **203 610.63 lekë**, i rezultoi se nga përlllogaritjet dukej se të ardhurat nga pagat për periudhën 1.1.2017 – më 30.1.2017, nuk justifikonin krijimin e shumave 500 000 lekë dhe 5 000 euro.

4.5 Mbi këtë konstatim, Komisioni e ka pyetur<sup>29</sup> subjektin, i cili në deklarinimin e tij ka cituar: “... në deklarinimet e gjendjes *cash*, deri në vitin 2014 kam pasqyruar gjendjen totale *cash* që kisha në banesë. Në deklarinimin e vitit 2015, pasi u instruktova për mënyrën e plotësimit të formularit në lidhje me këtë pikë, kam pasqyruar vetëm kursimet e atij viti, që në rastin konkret ishin shtesat e krijuara nga te ardhurat nga paga për atë vit. Pra, totali i gjendjes *cash* në vitin 2015, ka qenë në shumën 1 500 000, të akumuluar ndër vite + 150 000 kursime sipas formularit të deklarinimit periodik të vitit 2015 = 1 650 000 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Deklarimi ‘Vetting’ i plotësuar prej meje me datë 30.1.2017, paraqet të dhënat ekzistuese deri në momentin e plotësimit të këtij deklarimi, duke përfshirë dhe ndryshimet e ndodhura gjatë vitit 2016. Në këtë kohë nga ana ime nuk ishte plotësuar akoma deklarimi periodik për ndryshimet e ndodhura në vitin 2016. Deklarimi për vitin 2016 është plotësuar në fund të muajit mars të vitit 2017. Në këtë mënyrë në deklarinimin ‘Vetting’, të plotësuar 30.1.2017 është pasqyruar gjendja *cash*, e mbetur deri në datën e plotësimit të këtij deklarimi, dhe konkretisht në shumat 5000 euro dhe 500 000 lekë. Më pas, me dorëzimin e deklaratës periodike për vitin 2016, të plotësuar me datë 31.3.2017, është konsideruar i ezauruar deklarimi edhe për periudhën janar 2016 – dhjetor 2016. Për këtë arsye nuk është ri deklaruar gjendja *cash* në shumat respektive me mendimin se mund të konsiderohej si shtesa mbi gjendjen e pasqyruar në deklarinimin ‘Vetting’, të kryer 2 muaj përpara deklarinimit periodik të vitit 2016...”

4.6 Nga përlllogaritjet e kryera, Komisionit i rezultoi se midis vlerës së deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe vlerës së mbartur prej vitit 2015 në vitin 2016, sipas deklarinimit të subjektit, diferenca ishte në shumën **473 650 lekë**. Më konkretisht, kjo diferencë i referohej shumës 1 650 000 lekë, të mbartur në vitin 2016 nga vitin 2015 dhe shumës totale<sup>30</sup> 1 176 350 lekë (kjo e fundit përbëhet nga 5 000 euro + 500 000 lekë të deklaruar në deklaratën “Vetting”), e cila nuk rezultonte të ishte deklaruar si vlerë e pakësuar në vitin 2016, sikurse subjekti shprehej se vetëm në vitin 2015 kishte rregulluar gjendjen *cash*, duke saktësuar vetëm shtesa dhe pakësimi.

4.7 Komisioni, nga analizimi i fakteve dhe rrethanave të përshkruara më sipër, për të qartësuar këtë situatë, i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

### **4.8 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni**

Subjekti, në shpjegimet e tij, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse është shprehur në pyetësor<sup>31</sup>. Ndër të tjera, ai ka theksuar se deklarimi periodik për vitin 2016 është plotësuar dhe dorëzuar në datën 31.3.2017, pra 2 muaj pas deklarinimit “Vetting”, i cili ishte plotësuar dhe dorëzuar në datën 30.1.2017. Pakësimi i kësaj shume është konsideruar i kryer me deklarinimin “Vetting”, i cili paraqet gjendjen edhe të kursimeve *cash* deri në datën 31.1.2017. Deklarimi periodik i vitit 2016, paraqet ndryshimet e gjendjes *cash* në raport me deklarinimin “Vetting”.

<sup>29</sup> Referojuni pyetësorit datë 19.6.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>30</sup> Referojuni kursit mesatar vjetor të këmbimit euro/lekë në Bankën e Shqipërisë (1 euro = 135.27 lekë)

<sup>31</sup> Referojuni pyetësorit datë 19.6.2019, në dosjen e Komisionit.

## *Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta*

### **4.9 Vlerësimi i Komisionit**

Trupi gjykues çmon se pavarësisht saktësimeve të bëra nga subjekti lidhur me konstatimet e gjendjes *cash*, deklarata periodike vjetore, sipas parashikimit ligjor në ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar, kërkon plotësimin dhe pasqyrimin e saktë të situatës financiare nga çdo subjekt deklarues deri në datën 31 dhjetor të vitit përkatës, veprim të cilin subjekti i rivlerësimit nuk e ka përmbushur në mënyrë të saktë. Deklarata “Vetting”, shtojca nr. 2, ka kërkuar përmbushjen e detyrimeve ligjore në kuptim të nenit 31, të ligjit nr. 84/2016.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në lidhje me deklarimin mbi gjendjen *cash*, veprim ky i cili nuk rezulton të ketë pasojë negative në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor.

**5. Në lidhje me *overdraft* në “Credins Bank”, në llogarinë nr. (\*\*\*) , në vlerën 200 000 lekë, mbetur pa shlyer 128 816 lekë.**

5.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë, është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.*

5.2 Komisionit, nga korrespondenca e mbajtur me “Credins Bank”, i rezultoi se ky institucion, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 30.4.2019, konfirmon *overdraft*-in në vlerën 200 000 lekë, me detyrim 128 816 lekë.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “Credins Bank”.

**6. Në lidhje me *overdraft* në “Credins Bank”, në llogarinë nr. (\*\*\*) , në vlerën 100 000 lekë, mbetur pa shlyer 55 639 lekë.**

6.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë, është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.*

6.2 Komisionit, nga korrespondenca e mbajtur me “Credins Bank”, i rezultoi se ky institucion, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 30.4.2019, konfirmon *overdraft*-in në vlerën 100 000 lekë, me detyrim 55 639 lekë.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “Credins Bank”.

### **DEKLARIMI I PASURISË SË BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**7. Në lidhje me *autoveturën me targa AA* (\*\*\*) , blerë në vitin 2005, në shumën 20 000 euro, në emër të M. K. . Pjesa takuese: 100%. **Burimi i deklaruar i krijimit:** Të ardhurat familjare dhe me kredi nga “NGB”, në shumën 10 000 euro.**

7.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur DPSHTRR-ja dhe “NGB”-ja.*

7.2 Gjatë hetimit administrativ, Komisionit i rezultoi se subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2005, në vlerën 20 000 USD.

7.3 Nga korrespondenca e mbajtur me DPSHTRR-në, ky institucion, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 16.5.2018, konfirmon automjetin në pronësi të bashkëshortes së subjektit, M. K. .

7.4 Nga aktet e administruara në dosjen e hetimit administrativ rezultoi se kjo pasuri ishte blerë në vlerën 19 000 euro, sipas faturës së shitjes nr. (\*\*\*) , datë 21.12.2005, nga “(\*\*\*)” sh.p.k.

**Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta**

7.5 Komisioni e ka pyetur<sup>32</sup> subjektin në lidhje me këtë mospërputhje vlerash monetare dhe në përgjigjen e dhënë ai ka konfirmuar për këtë automjet vlerën 19 000 euro.

7.6 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar të ardhurat familjare, si dhe kredinë e marrë në “NBG”.

7.7 Nga hetimi rezultoi se shuma e marrë kredi ishte në vlerën 10 205 euro dhe jo 10 000 euro, siç deklarohet nga subjekti.

7.8 Komisioni kreu analizën financiare lidhur me mundësinë financiare për blerjen e këtij automjeti.

7.9 Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet analiza nga momenti i blerjes së pasurisë, viti 2005, deri në momentin e përfundimit të kredisë, viti 2009, e cila ka shërbyer si burim i kësaj pasurie.

**Tabela nr. 5**

	<b>Përshkrimi</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>
<b>1</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>2,118,504</b>	<b>1,746,032</b>	<b>2,332,284</b>	<b>2,049,799</b>	<b>2,685,321</b>
	Të ardhura nga paga, subjekti	1,590,315	1,574,230	1,642,375	1,807,319	1,835,562
	Të ardhura nga paga, bashkëshortja	424,859	171,802	189,909	242,480	849,759
	Të ardhura nga shitja e autoveturës “Volvo”, TR (***)	103,330	-	-	-	-
	Të ardhura nga shitja e autoveturës “Landrover” TR (***)	-	-	500,000	-	-
<b>2</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>(581,709)</b>	<b>865,932</b>	<b>1,342,840</b>	<b>898,312</b>	<b>1,060,199</b>
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	438,228	438,228	943,872	546,480	546,480
	Kredia në “NBG” (10.205 euro) (principal + interes)	(1,250,521)	345,614	398,968	344,497	460,772
	Shpenzime TIMS	230,584	82,091	-	7,335	52,947
<b>3</b>	<b>PASURI</b>	<b>2,860,283</b>	<b>1,146,237</b>	<b>387,641</b>	<b>393,293</b>	<b>211,968</b>
	<b>Pasuri e paluajtshme/e luajtshme</b>					
	Shtëpi banimi 2-kate 120m <sup>2</sup> , Rr. “(***)” (trashëgimi)	-	686,579	711,654	526,140	175,380
	Autoveturë “Landrover” TR (***) (shitur në 2007)	521,817	-	-	-	-
	Autoveturë “Golf” TR (***), targa AA (***)	2,337,000	-	-	-	-

<sup>32</sup> Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 6.5.2019, në dosjen e Komisionit.

## Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta

<i>Ndryshim likuiditeti</i>	1,467	459,657	(324,013)	(132,847)	(387,348)
<b>DIFERENCA (1-2-3)</b>	<b>-160,937</b>	<b>-266,137</b>	<b>601,803</b>	<b>758,193</b>	<b>1,837,091</b>

Komisioni, nga analizimi i fakteve dhe rrethanave, të përshkruara më sipër për hetimin e kësaj pasurie të luajtshme, konstatoi dhe për rrjedhojë i kërkoi shpjegime subjektit se:

- i. dukej se kishte mospërputhje për vlerën e blerjes së kësaj pasurie, në deklaratën “Vetting”, deklaruar në shumën 20 000 euro, në deklaratën për vitin 2005, deklaruar në shumën 20 000 dollarë dhe faturës<sup>33</sup> së blerjes ku pasqyrohet shuma 19 000 euro, si dhe i kaloi barrën<sup>34</sup> e provës, pasi nga analiza financiare, pasqyruar në tabelën nr. 4 më lart, ka konstatuar se:
  - ii. dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 426 208 lekë në vitin 2005 dhe 2006 për të investuar në blerjen e kësaj pasurie/automjet, për shlyerjen e kredisë në vitet në vazhdim, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

### 7.10 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në prapësimet e tij, kundërshton rezultatin negativ të analizës financiare të Komisionit, duke kundërshtuar përlllogaritjet e shpenzimeve TIMS. Sipas tij, nuk duhet të përfshihen shpenzimet për një udhëtim pune të vetë subjektit, të bashkëshortes dhe shkolla një javore e vajzës në Budapest. Për udhëtimin e punës subjekti deklaroi: “...kam qenë për një periudhë 3 ditore për arsye pune si përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme, në Strasbourg” dhe për këtë depozitoi shkresën<sup>35</sup> nga prokuroria. Për udhëtimin e bashkëshortes, ka deklaruar: “...këtë vit bashkëshortja ime ka qenë në Bochum, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes 2-palëshe, ndërmjet liceut kombëtar artistik ‘(\*\*\*)’ dhe shkollës së muzikës në Bochum.” Për këtë ka depozituar gazetën që përshkruan këtë lajm dhe marrëveshjen.

Për udhëtimin e vajzës, ka depozituar vetëm një komunikim me e-mail të ditëve pas rezultateve të hetimit ku kërkohet informacion për pjesëmarrjen e vajzës.

### 7.11 Vlerësimi i Komisionit

7.11.1 Trupi gjykues, në lidhje me mospërputhjet e konstatuara nga deklaratimet e subjektit lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie, ku në deklaratën “Vetting” ka deklaruar shumën 20 000 euro, në deklaratën për vitin 2005 ka deklaruar shumën 20 000 USD dhe faturës<sup>36</sup> së blerjes ku pasqyrohet shuma 19 000 euro, çmon se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, për shkak se nuk i është referuar vlerës së përcaktuar në faturën e depozituar në dosjen e Komisionit.

7.11.2 Trupi gjykues, në lidhje me konstatimin se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 426 208 lekë në vitet 2005 dhe 2006 për të investuar në blerjen e kësaj pasurie/automjet, për shlyerjen e kredisë në vitet në vazhdim, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, pasi vlerësoi provat, mori në konsideratë pretendimet e subjektit për të mos përlllogaritur në analizën financiare, shumën që i përkiste: (i) udhëtimit të tij për një periudhë 3 ditore për arsye pune si përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme, në Strasbourg për të cilin depozitoi edhe dokumentin provues; si dhe (ii) shumën që i përkiste udhëtimit të

<sup>33</sup> Referojuni faturës së shitjes nga “(\*\*\*)” sh.p.k., nr. (\*\*\*) , datë 21.12.2005, në dosjen e Komisionit.

<sup>34</sup> Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, referoni rezultatet për specifikimet në detaje.

<sup>35</sup> Nr. (\*\*\*)prot., datë 19.7.2019, dhe dokumentacionit bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit.

<sup>36</sup> Referojuni faturës së shitjes nr. (\*\*\*) , datë 21.12.2005, nga “(\*\*\*)” sh.p.k., në dosjen e Komisionit.

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

bashkëshortes, e cila kishte qenë në Bochum, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes 2-palëshe, ndërmjet liceut kombëtar artistik “(\*\*\*)” dhe shkollës së muzikës në Bochum, për të cilën subjekti gjithashtu depozitoi gazetën që përshkruante këtë lajm dhe marrëveshjen, por nuk u mor në konsideratë; (iii) pretendimin e subjektit edhe për shumën e shpenzuar për udhëtimin e vajzës, pasi komunikimi me *e-mail* nuk provonte nëse ajo kishte qenë pjesëmarrëse ose jo dhe nëse i ishin rimbursuar shpenzimet; kreu rillogaritjet financiare, nga ku rezultoi se përsëri subjekti konfirmohet në balancë negative në shumën 319 074 lekë në vitin 2005 dhe 2006 për të investuar në blerjen e kësaj pasurie/automjet, për shlyerjen e kredisë në vitet në vazhdim, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 319 074 lekë në vitet 2005 dhe 2006 për të investuar në blerjen e kësaj pasurie/automjet, për shlyerjen e kredisë në vitet në vazhdim, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

**8. Në lidhje me *overdraft* në “Credins Bank”, në vlerën 105 000 lekë, mbetur pa shlyer 64 480 lekë.**

8.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë, është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.*

8.2 Komisionit, nga korrespondenca e mbajtur me “Credins Bank”, i rezultoi se ky institucion, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 30.4.2019, konfirmon *overdraft*-in në vlerën 105 000 lekë, me detyrim 64 480 lekë.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “Credins Bank”.

### **DEKLARIMI I PASURISË SË DJALIT TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**9. Automjet i tipit “Smart” me targa AA (\*\*\*)**, blerë në vitin 2011, në shumën 5 000 euro, me kontratë nr. (\*\*\*) . Pjesa takuese: 100%. **Burimi i deklaruar i krijimit:** Kursimet familjare nga pagat.

9.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë, është shprehur: *Ky automjet nuk është deklaruar në deklaratën e interesave private “Periodik vjetor 2011”.*

9.2 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, rezultoi se këtë pasuri subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011, vit në të cilin kjo pasuri është blerë.

9.3 Nga korrespondenca e mbajtur me DPSHTRR-në, rezultoi se ky institucion, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 16.5.2018, konfirmon automjetin në pronësi të djalit të subjektit, J. K., sipas kontratës nr. (\*\*\*) , datë 21.9.2011.

- ✓ Komisioni kreu analizën financiare lidhur me burimin e ligjshëm të shumës së shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie, nga ku i rezultoi se personi i lidhur, djali i subjektit të rivlerësimit, ka pasur mundësi financiare për të investuar në blerjen e kësaj pasurie.

**10. Në lidhje me motor i tipit “Harley” me nr. shasie (\*\*\*)**, blerë në shumën 500 000 lekë, me kontratë nr. (\*\*\*) , datë 26.5.2016. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat e familjes.

10.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë, është shprehur: *Motori nuk është deklaruar në deklaratën e interesave private “Periodik vjetor 2016”.*

10.2 Komisionit, nga korrespondenca e mbajtur me DPSHTRR-në, i rezultoi se ky institucion, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 16.5.2018, konfirmon mjetin në pronësi të djalit të subjektit, J. K. .



## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

10.3 Gjatë hetimit administrativ rezultoi se djali i subjektit të rivlerësimit ka statusin e bashkëjetuesit. Për një hetim objektiv në lidhje me këtë pasuri (në kohën e blerjes së saj) Komisioni ka pyetur<sup>37</sup> subjektin mbi përbërjen familjare, periudhën në të cilën djali i tij është ndarë nga trangu familjar, me qëllim provueshmërinë e faktit nëse djali i subjektit përfshihej në kategorinë e personave të lidhur.

10.4 Subjekti, në përgjigjen e tij, ka deklaruar se djali i tij është shkëputur nga trangu familjar në datën 14.10.2016 dhe për këtë ka vënë në dispozicion certifikatën familjare të Zyrës së Gjendjes Civile Njësia Bashkiake nr. 2, lëshuar në datën 25.6.2019.

10.5 Lidhur me këtë pasuri, Komisionit nga hetimi i rezultoi se subjekti nuk e kishte deklaruar këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2016, vit në të cilin ajo është blerë.

10.6 Komisioni kreu analizën financiare, nga ku nuk rezultuan balanca negative për krijimin e kësaj pasurie të luajtshme.

10.7 Në analizë të deklarimeve të subjektit, Komisionit i rezultoi se:

- i. Subjekti nuk e kishte deklaruar këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 dhe për këtë i kërkoi të japë shpjegime.

### **10.8 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni**

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka sqaruar se deklarimi i blerjes së këtij motori është bërë në deklaratën “Vetting”, të plotësuar dhe të dorëzuar dy muaj përpara deklarimit periodik të vitit 2016. Në deklarimin periodik të vitit 2016, plotësuar dhe dorëzuar në datën 31.3.2017, motori në fjalë është konsideruar i deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”, të plotësuar dhe të dorëzuar në datën 30.1.2017.

### **10.9 Vlerësimi i Komisionit**

Trupi gjykues, në analizë të sqarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, çmon se fakti i pretenduar nga subjekti se ky automjet është deklaruar në deklaratën “Vetting”, nuk është arsye për mosdeklarimin në deklaratën periodike, pasi pasuria deklarohet në kohën e krijimit të saj. Ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, kërkon specifikisht plotësimin e saktë të deklaratës periodike vjetore.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues çmon se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën periodike për vitin 2016.

### **11. Në lidhje me llogari page në “BKT”, me vlerë 1 820 lekë.**

11.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë, është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “BKT”-ja.*

11.2 Komisionit, nga korrespondenca e mbajtur me “BKT”-në, i rezultoi se ky institucion, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 15.5.2018, konfirmon llogarinë e pagës me gjendje 1 820 lekë deri më 30.1.2017.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “BKT”-së.

### **12. Në lidhje me llogari në “Credins Bank”, me balancë kreditore në vlerën 5 253,98 lekë.**

12.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë, është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.*

---

<sup>37</sup> Referojuni pyetjes në tekst të e-mail-it datë 25.6.2019, në dosjen e Komisionit.

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

12.2 Komisionit, nga korrespondenca e mbajtur me “Credins Bank”, i rezultoi se ky institucion, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 30.4.2019, konfirmon llogarinë me balancë kreditore në shumën 5 253,98 lekë.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “Credins Bank”.

**13. Në lidhje me kredi në “BKT” me kontratë datë 6.6.2016, në shumën 250 000 lekë; kontrata dhe vërtetimi i “BKT”-së, datë 26.1.2017. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer 180 586,25 lekë.**

13.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “BKT”-ja.*

13.2 Komisionit, nga korrespondenca e mbajtur me “BKT”-në, i rezultoi se ky institucion, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 15.5.2018, konfirmon kredinë në shumën 250 000 lekë, me detyrim të mbetur 180 586,25 lekë, deri më 30.1.2017.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “BKT”-së.

**14. Në lidhje me kartë krediti në “BKT”, në shumën 200 000 lekë.**

14.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë, është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “BKT”-ja.*

14.2 Komisionit, nga korrespondenca e mbajtur me “BKT”-në, i rezultoi se ky institucion, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 15.5.2018, konfirmon kartën e kreditit në shumën 200 000 lekë, me detyrim 0 lekë, deri më 30.1.2017.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “BKT”-së.

**15. Overdraft në “Credins Bank” në shumën 150 000 lekë. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, 150 000 lekë.**

15.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.*

15.2 Komisionit, nga korrespondenca e mbajtur me “Credins Bank”, i rezultoi se ky institucion, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 30.4.2019, konfirmon *overdraft*-in në vlerën 150 000 lekë, me detyrim 150 000 lekë.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “Credins Bank”.

## **DEKLARIMI I PASURISË SË VAJZËS SË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

### **Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ**

**16. Në lidhje me apartament nr. (\*\*\*)**, me sip. 61.8 m<sup>2</sup>, ndodhur në katin e shtatë të godinës nëntëkatëshe, në Rr. “(\*\*\*)”, blerë në shumën 48 935 euro, me kontratë nr. (\*\*\*) , datë 20.12.2016, nga A. P., me të cilin bashkëjetojnë. Pjesa takuese: 50%.

16.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë është shprehur: *Apartamenti me sip. 61.8 m<sup>2</sup>, me adresë Rr. “(\*\*\*)”, blerë sipas kontratës së sipërmarrjes datë 6.12.2010 dhe kontratës së shitjes nr. (\*\*\*) , nga shtetasi A. P. dhe S. K., në shumën 48 935 euro, nuk është deklaruar në asnjë nga deklaratat e interesave private të dorëzuara në ILDKPKI.*

## **Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta**

16.2 Komisionit, gjatë hetimit administrativ i rezultoi se vajza e subjektit kishte statusin e bashkëjetueses. Për një hetim objektiv në lidhje me këtë pasuri Komisioni ka pyetur<sup>38</sup> subjektin mbi përbërjen familjare, periudhën në të cilën vajza e tij është ndarë nga trangu familjar.

16.3 Subjekti, në përgjigjen e dhënë, ka deklaruar se vajza e tij është shkëputur nga trangu familjar në datën 24.10.2016 dhe për këtë ka vënë në dispozicion certifikatën familjare të Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr. 2, lëshuar në datën 25.6.2019, sipas të cilës provohet një fakt i tillë. Për pasojë, provohet edhe fakti se vajza e subjektit përfshihej në kategorinë e personave të lidhur.

16.4 Më tej, nga hetimi administrativ në lidhje me këtë pasuri, Komisionit i ka rezultuar se me kontratën e sipërmarrjes datë 6.12.2010 është porositur apartamenti me çmim 48 935 euro, në të cilën rezultoi se vajza e subjektit është me cilësinë e njëjës prej palës blerëse.

16.5 Rezultoi se subjekti **nuk e kishte deklaruar** këtë pasuri **në deklaratën për vitin 2010**, kohë në të cilën është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes **dhe as në vitin 2016 kur është nënshkruar kontrata e shitjes.**

16.6 Në kontratën e shitjes<sup>39</sup>, në germen “d” të saj, rezulton se palët kanë lidhur më parë një kontratë sipërmarrjeje në datën 6.12.2007 dhe, gjithashtu, nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti rezultoi se kësti i parë i kësaj pasurie (sikurse citohet edhe në pikën 16.11 më poshtë) ishte paguar në datën 6.12.2007, në shumën 25 000 euro, ndërsa nuk rezultoi që kontrata e vitit 2007 të pasqyrohej në kontratën e sipërmarrjes të vitit 2010.

16.7 Në praktikën e ZVRPP-së Tiranë, administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ZVRPP-ja ka konfirmuar regjistrimin e kësaj pasurie në emrin e vajzës së subjektit dhe për këtë ka vënë në dispozicion edhe vërtetimin nga dokumenti hipotekor, nr. (\*\*\*) , datë 29.12.2016 në emër të shtetasit A. P. dhe vajzës së subjektit të rivlerësimit, znj. S. K., ndërsa në praktikën e ardhur nga ZVRPP-ja<sup>40</sup> Tiranë, pasqyrohet se në emër të vajzës së subjektit nuk figurojnë pasuri aktuale apo të tjetërsuara.

16.8 OSHEE-ja<sup>41</sup> nuk konfirmon lidhje të kontratës së furnizimit me energji elektrike në emër të vajzës së subjektit.

16.9 Komisioni e ka pyetur<sup>42</sup> subjektin në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie.

16.10 Në përgjigjen e dhënë subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar: ... *bashkëjetuesi i vajzës së tij është nga biznesmenët e parë në vendin tonë dhe konkretisht e ka filluar aktivitetin tregtar që prej janarit 1992 nëpërmjet disa shoqërive të cilat i ka cituar shprehimisht në përgjigje të pyetësorit. Po ashtu, ka sqaruar se për disa prej shoqërive ka kaluar kohë e gjatë nga ushtrimi i aktivitetit të tyre dhe për pasojë nuk gjenden dokumente apo bilance të shoqërisë. Subjekti ka deklaruar se A. P. ka qarkulluar shuma të konsiderueshme parash që në vitet e para të demokracisë në bizneset e tij dhe për rrjedhojë ka pasur të ardhura dhe kursime mëse të mjaftueshme, për blerjen e një banese me sipërfaqe 61,8m<sup>2</sup>. Në datën 28.10.2004, z. P. ka themeluar shoqërinë “(\*\*\*)” (A.I.C.) sh.p.k., së bashku me z. V. A. . Prej datës 16.5.2011 dhe në vijim ai është njëkohësisht edhe administrator i shoqërisë “(\*\*\*)” (A.I.C.) sh.p.k., në datën 6.12.2007 A. P. në cilësinë e blerësit, ka nënshkruar me shoqërinë “(\*\*\*)” (A.I.C.) sh.p.k., në cilësinë e shitësit, kontratën e porosisë për blerjen e apartamentit me sipërfaqe prej 61,8 m<sup>2</sup>, në adresën: Rr. “(\*\*\*)”, në vlerën 48 935 (dyzetë e tetëmijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë)*

<sup>38</sup> Referojuni pyetjes në tekst të e-mail-it datë 25.6.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>39</sup> Referojuni aneksit nr. 28, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>40</sup> Referojuni shkresës nr. (\*\*\*) prot., datë 21.5.2018 dhe dokumentacionit bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit.

<sup>41</sup> Referojuni shkresës nr. (\*\*\*) prot., datë 29.5.2018, në dosjen e Komisionit.

<sup>42</sup> Pyetësori nr. 2 datë 6.5.2019, në dosjen e Komisionit.

## **Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta**

euro. Po në këtë datë ai ka depozituar në llogarinë e shoqërisë “(\*\*\*)” (A.I.C.) sh.p.k., pranë “Bankës Kombëtare Tregtare”, nëpërmjet motrës së tij, znj. E. P., shumën prej 25 000 (njëzetë e pesëmijë) euro, për pagesë kësti për blerjen e apartamentit të sipërcituar. Këto të ardhura janë krijuar si pasojë e zhvillimit të aktivitetit tregtar ndër vite. Vlera e mbetur, prej 23 935 euro, është likuiduar:

- Nëpërmjet Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “(\*\*\*)” (A.I.C.), datë 30.11.2016, është vendosur që vlera e pagave neto për periudhën prill 2013 deri më tetor 2016, të papaguara për këtë periudhë kundrejt z. A. P. për pozicionin e administratorit pranë “(\*\*\*)” (A.I.C.) sh.p.k., në shumën prej 3 009 756 (tre milionë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë, konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë të barabartë me 1 euro: 135,86 ALL, përlllogaritur në 22 153 (njëzetë e dymijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë) euro, të shërbejë si pagesë e këstit dytë të apartamentit me sipërfaqe 61,8 m<sup>2</sup>.
- Kësti i mbetur në shumën prej 1 782 (njëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) euro është derdhur pranë arkës së shoqërisë, nga kursimet e tij.

16.10.1 Subjekti ka deklaruar se ky apartament ndodhet në pallatin që është ndërtuar nga shoqëria “(\*\*\*)” (A.I.C.) sh.p.k., (e cila ka qenë investitore dhe zbatuese) dhe se z. A. P. është zotërues i 40% të kapitalit të shoqërisë “(\*\*\*)” (A.I.C.) sh.p.k., pjesë e cila ka një vlerë prej 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekësh. Po ashtu, subjekti ka deklaruar se për të ardhurat nga paga e z. P. për periudhën nga shtator 2011 deri në dhjetor 2016 janë paguar rregullisht Kontributet e Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimi mbi të Ardhurat Personale. Subjekti, së bashku me deklaratimet ka depozituar disa dokumente<sup>43</sup>.

16.11 Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti, Komisionit i ka rezultuar se:

- Kësti i parë i kësaj pasurie është paguar në datën 6.12.2007, në shumën 25 000 euro. Kjo shumë është derdhur *cash* nga shtetasja E. P. për llogari të kompanisë “(\*\*\*)” (A.I.C.) me përshkrimin “Pag Kësti”, datë kjo që daton **3 vjet përpara lidhjes së kontratës së sipërmarrjes së vitit 2010**.
- Kësti i dytë në shumën 22 153 euro është paguar në datën 30.11.2016. Pagesa e kësaj shume vjen si rezultat i vendimit nr. 4 të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “(\*\*\*)” (A.I.C.). Në këtë vendim ortakët kanë vendosur që pagat e pamarra për periudhën prill 2013 – tetor 2016 të shtetasit A. P. të shërbejnë si pagesë e këstit të dytë për apartamentin me sip. 61.8 m<sup>2</sup>. Pagat në shumën 3 009 756 lekë, konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë 1 euro e barabartë me 135.86 lekë.
- Kësti i tretë në shumën 1 782 euro në datën 2.12.2016; dorëzuar mandatarkëtimi.

16.12 Nga hetimi i mëtejshëm i Komisionit<sup>44</sup> i rezultoi se shtetasi A. P. është aksioner në subjektin “(\*\*\*)” (A.I.C.), shoqëri me statusin aktiv nga data 20.7.2004. Në dokumentet e

<sup>43</sup> Vendim nr. (\*\*\*) , datë 17.1.1992, të Gjykatës së Rrethit Tiranë; vendim nr. (\*\*\*) , datë 19.7.1993, të Gjykatës së Rrethit Tiranë; deklaratë doganore datë 16.1.1995, për pagesën në doganë për 34.184 litra benzinë, me vlerë fature 4 043 USD dhe pagesë në doganë 1 746 018 lekë; deklaratë doganore datë 16.1.1995, për pagesën në doganë për 35.026 litra benzinë, me vlerë fature 4 116 USD dhe pagesë në doganë 1 795 225 lekë; deklaratë doganore së bashku me praktikën, datë 26.2.1998 për pagesën në doganë për 594 600 litra naftë, me vlerë fature 75 991 USD dhe pagesë në doganë 27 267 633 lekë; vërtetim lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare për pagesën e këstit 25 000 euro; vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “(\*\*\*)” (A.I.C.), datë 30.11.2016; mandatarkëtimi i shoqërisë “(\*\*\*)” (A.I.C.), për pagesën e këstit të fundit, nr. 2, datë 2.12.2016; Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar të shoqërisë “(\*\*\*)” (A.I.C.); vërtetim për bazën e vlerësuar nr. (\*\*\*) prot., datë 9.5.2019, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për z. A. P., për periudhën janar 2012 – shkurt 2019, ku reflektohet paga mbi të cilin është derdhur kontributi (të dhënat për periudhën përpara janar 2012 nuk janë në sistemin informatik); nga regjistrat e shoqërisë (listpagesa e ESIG-(\*\*\*)) është bashkëngjitur vërtetim për bazën e vlerësueshme për pagat *bruto* dhe *neto* të realizuara nga z. P. prej periudhës 3.9.2011 – më 31.12.2016.

<sup>44</sup> Shkresë nr. (\*\*\*) prot., datë 22.5.2019, nga DPT-ja.

## **Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta**

administruara në dosjen e ILDKPKI-së rezulton se kompania (\*\*\*)” (A.I.C) ka qenë me fitim nga viti 2005 – 2013, por nuk ka shpërndarë dividend, ndërsa pas vitit 2013 rezultonte se kompania kishte dalë me humbje.

Në analizë të fakteve dhe provave më sipër, Komisionit i ka rezultuar dhe për pasojë i ka kaluar barrën e provës<sup>45</sup>, se:

- i. dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm për pagesën e kështit të parë dhe të tretë të kësaj pasurie;
- ii. mungonte kontrata e sipërmarrjes datë 6.7.2007, e cituar në kontratën e shitjes nr. (\*\*\*), datë 20.12.2016, nënshkruar edhe nga vajza e tij, znj. S. K.;
- iii. mungonte dokumentacioni i plotë i regjistrimit të kësaj pasurie në ZVRPP-në Tiranë, në emër të vajzës së subjektit dhe bashkëshortit të saj, sikurse ai ka deklaruar se secili gëzon 50% të pjesës takuese të kësaj pasurie.

Gjithashtu, nga analiza e dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ është konstatuar dhe, për pasojë, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime, pasi dukej se:

- i. kjo pasuri nuk ishte deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 dhe as në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016;
- ii. kishte mospërputhje midis deklaramit të subjektit në deklaratën “Vetting” se kjo pasuri është krijuar me kontributin e bashkëshortit të vajzës së subjektit dhe deklarimit po në këtë deklaratë se kjo pasuri zotërohet 50% nga vajza e tij;
- iii. kontrata e sipërmarrjes e vitit 2010 për këtë pasuri, nuk ka shërbyer si burim për formalizimin e kontratës së shitjes të vitit 2016, pasi në këtë të fundit është pasqyruar kontrata e vitit 2007.

### **16.13 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni**

Subjekti në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka sqaruar se *në pasurinë apartament me nr. (\*\*\*), me sipërfaqe 61.8 m<sup>2</sup> vajza e tij, S. K., është pronare në kuotën 50% ...pjesa takuese 50%, (sqaroi se) pagesa për kështin e parë në shumën prej 25 000 (njëzetë e pesë mijë) euro, është bërë më datë 6.12.2007, në të njëjtën ditë kur është nënshkruar Kontrata e Sipërmarrjes midis subjektit “(\*\*\*)” (A.I.C.) sh.p.k., dhe z. A. P. . Kjo pagesë është derdhur me para në dorë pranë sporteleve të Bankës Kombëtare Tregtare, në llogarinë e shoqërisë “(\*\*\*)” (A.I.C.) sh.p.k., nga të ardhurat personale të përfituesit të apartamentit, z. A. P. .*

**Në lidhje me burimin e ligjshëm për kështin e parë**, subjekti ka sqaruar se *burimi i të ardhurave të kësaj shume është fitimi i siguruar nga puna/aktiviteti i tij, prej vitit 1993 deri në vitin 1998, me importin e hidrokarbureve nga Greqia në Shqipëri dhe tregtimin i cigareve nga viti 1992 – 1994. Ndër të tjera, subjekti ka cituar se ...marzhi i fitimit për periudhën ku flasim, ka qenë minimalisht 20% mbi qarkullimin, që e kthyer në vlerë parash është 91 000 (nëntëdhjetë e një mijë) USD fitim, vetëm për këto tre furnizime të pasqyruara në deklaratat doganore që disponon z. P. .*

**Në lidhje me pagesën e kështit të tretë**, ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar se *...përveç kursimeve si pasojë e zhvillimit të aktivitetit tregtar ndër vite, provohet se nga vërtetimi për bazën e vlerësueshme për pagat neto të realizuara, z. A. P. prej 3.9.2011 – 31.3.2013, ka realizuar të ardhurat neto në vlerën prej 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekësh. Pra, të ardhurat e tij kanë qenë të mjaftueshme për të paguar kështin e tretë në vlerën prej 1.782 (një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy) euro. Subjekti ka sqaruar se në vitin 2007, kur është*

<sup>45</sup> Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, refero rezultatet për specififikimet në detaje.

## **Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta**

*nënshkruar kontrata e sipërmarrjes midis “(\*\*\*)” (A.I.C.) sh.p.k., dhe z. A. P., vajza e tij, S. K. nuk ka qenë e lidhur me z. A. P., dhe ky i fundit, në cilësinë përfaqësuesit/ortakut të shoqërisë tregtare për shkak se nuk ka qenë subjekt deklarimi, nuk ka pasur detyrim ligjor të posaçëm për të ruajtur dokumente të cilat provonin të ardhura, pasi në ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrave financiare, dokumentet kontabël ruhen për 10 vjet rresht pas mbylljes së periudhës raportuese. Kontrata e sipërmarrjes e datës 6.12.2010, sipas sqarimeve të dhëna nga z. A. P., ka një lapsus për sa i përket vitit, në numrin e fundit rendor, pasi kjo kontratë është lidhur në vitin 2016, disa ditë para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, por gabimisht është vendosur viti 2010. Në vitin 2010 A. P. dhe S. K. ende nuk ishin njohur me njëri-tjetrin. Ata janë njohur në mesin e vitit 2013 dhe për pasojë kontrata nuk mund të datonte në vitin 2010. Dokument bazë për formalizimin e kontratës së shitjes është kontrata e sipërmarrjes së vitit 2007, dhe për këtë arsye noteria në kontratën e shitjes ka cituar pikërisht këtë kontratë. Në lidhje me konstatimet e Komisionit për mosdeklarimin e pasurisë, në vitin 2010 nuk ka pasur asnjë kontratë sipërmarrjeje, dhe si rrjedhojë s’ mund të ishte pjesë e deklarimeve të atij viti. Në vitin 2016 kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes dhe kontrata e shitjes, vajza S. K., nuk ka qenë në certifikatën familjare të subjektit të rivlerësimit. Deklarimet për vitin 2016 bëhen në vitin pasardhës që i bie viti 2017. ...Kontrata e sipërmarrjes në datën 6.12.2016 është nënshkruar për të përfshirë bashkëjetuesen në pronë, por kushtet e kontratës janë ato të vitit 2007 dhe nëse do të vini re, kontrata e sipërmarrjes së vitit 2016 është e njëjtë me atë të vitit 2007 edhe pse pagesat në këtë periudhë ishin kryer prej z. A. P. .*

Subjekti ka depozituar:

1. kontratën e shitjes së kësaj pasurie, datë 20.12.2016;
2. vërtetimin hipotekor të pasurisë në emër të shoqërisë “A.I.C” sh.p.k., lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë në datën 1.12.2016;
3. hartën treguese të regjistrimit të pasurisë;
4. kontratë sipërmarrje datë 6.12.2007, nënshkruar midis shoqërisë ndërtimore “A.I.C” sh.p.k. dhe shtetasit A. P.;
5. dokumente mbi dhënien e lejes së ndërtimit të godinës, si dhe skica planimetricke;
6. kontratë sipërmarrjeje datë 6.12.2010, nënshkruar midis shoqërisë ndërtimore të sipërcituar dhe shtetasve S. K. dhe A. P. .

### **16.14 Vlerësimi i Komisionit**

Trupi gjykues, në analizë të fakteve, ka çmuar se pavarësisht ndarjes së vajzës së subjektit nga trupu familjar në tetor të vitit 2016, në raport me kontratën e sipërmarrjes për këtë pasuri, të nënshkruar në vitin 2010 nga vajza e tij, ky akt/kontrata, përmbush kriteret që e bëjnë atë (vajzën e subjektit) person të lidhur. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ dhe analizimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se pretendimi i subjektit se kontrata datë 6.12.2010 është e vitit 2016 dhe se në të ka lapsus për sa i përket vitit të lidhjes së saj, nuk qëndron për faktin se, kontrata e sipërmarrjes e nënshkruar vetëm 14 ditë përpara nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes datë 20.12.2016, vlerësohet e pabesueshme, kur dispozitat, përkatësisht neni 850 e në vijim i Kodit Civil, mbi marrëdhëniet kontraktore të sipërmarrjes/porosisë, kërkojnë plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore në ndryshim nga kontrata e shitjes. Nënshkrimi i një kontrate sipërmarrjeje ka si objekt porosinë e një pasurie që pritet të ndërtohet apo po ndërtohet, kërkon angazhimin në kohë të ndryshme për shlyerje të detyrimeve, pra kjo marrëdhënia kontraktore shtrin efektet e saj në kohë dhe për pasojë, kurrsesi nuk mund të pranohet si e nënshkruar vetëm 14 ditë përpara kontratës së shitjes. Duke iu referuar kontratës së vitit 2010, vërehet se në nenin 8 të saj është parashikuar pikërisht edhe afati 20 mujor për ndërtimin e objektit dhe për rrjedhojë, mjafton ky fakt që të rrëzojë tërësisht pretendimin se kjo kontratë është nënshkruar vetëm 14 ditë përpara asaj të shitjes.

## *Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta*

Nëse kjo marrëdhënie kontraktore është realizuar thjesht dhe vetëm për të ligjëruar në këtë pasuri edhe vazhën e subjektit të rivlerësimit, sikurse ky i fundit pretendon, atëherë gjasat do të ishin që në kontratën e shitjes do të ishte cituar pikërisht kontrata e vitit 2010 dhe jo ajo e vitit 2007.

Lidhur me burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit mbi ushtrimin e aktivitetit të kompanisë, vlerëson se ky dokumentacion pasqyron faktin se kompania “(\*\*\*)” (A.I.C.) sh.p.k., (ka ushtruar aktivitet të ligjshëm, ka qenë me fitim nga viti 2005 – 2013, por nisur nga fakti se nuk ka shpërndarë dividend, se pas vitit 2013 rezultonte me humbje, si dhe duke i gërshetuar këto fakte edhe me problematikën mbi pretendimet e subjektit për kohën e nënshkrimit të kontratave, arrin në konkluzionin se:

- ✓ Subjekti i rivlerësimit, për këtë pasuri, nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pagesave të kryera për këstin e parë dhe të tretë të saj.

### **GJETJE TË TJERA**

17. Komisionit i rezultoi se subjekti kishte deklaruar në deklaratën “Vetting”: *Të ardhura nga qiradhënia e banesës në Rr. “(\*\*\*)”, nr. (\*\*\*)*, Tiranë, nr. pasurie (\*\*\*)*, për vitet 2006 – 2007, në shumën 2 300 625 lekë.*

17.1 ILDKPKI-ja, në lidhje me këtë deklaram, ka konstatuar: *Mungon dokumentacioni i plotë provues/justifikues, si kontrata e nënshkruar, etj., lidhur me dhënien me qira të banesës së deklaruar në shumën 2 300 625 lekë. (Subjekti ka paraqitur statement të llogarisë në emër të M. K., pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, për periudhën 31.12.2003 – 31.12.2014. Në këtë dokument evidentohen disa transferta të mbërritura në llogari, por nuk ka përshkrim të dërguesit në mënyrë që të vërtetohet qëllimi i përfitimit të tyre. Totali i transfertave është në vlerën 2 300 625 lekë.)*

17.2 Nga hetimi i kryer, Komisionit i rezultoi se subjekti:

- në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, kishte deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 1 380 000 lekë;
- në deklaratën për vitin 2007 nuk kishte **deklaruar të ardhura nga qiraja;**
- për këto të ardhura mungonte kontrata e qirasë.

17.3 Komisioni e ka pyetur<sup>46</sup> subjektin në lidhje me këto të ardhura, në lidhje me tatimin e paguar, si dhe i ka kërkuar të depozitojë kontratën/at përkatëse.

17.4 Komisionit i rezultoi se përveç pagesave të kryera nga qiramarrësi “U. – C. A. I.” në llogari të bashkëshortes së subjektit, ai nuk dorëzoi asnjë dokument tjetër ligjor justifikues. Në përgjigje të pyetësorit subjekti ka deklaruar se pas interesimit të bërë nuk kanë arritur të gjejnë kopje të kontratës së qirasë, madje është shprehur subjekti: *“... nuk jemi në gjendje të kujtojmë faktin nëse kemi pasur kontratë me shkrim, por theksojmë se të gjitha pagesat janë bërë nëpërmjet bankës, nga llogaria e C. A. I., në llogarinë tonë.”*

17.5 Nga pagesat në “Intesa Sanpaolo Bank”, në llogarinë e bashkëshortes së subjektit, rezultuan të ardhura nga qiraja në shumën 2 713 725 lekë.

17.6 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve<sup>47</sup> ka informuar se nuk ka informacion në lidhje me kontratën e qirasë ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe qiramarrësit “U. – C. A. I.”, si dhe pagesës së tatimit në burim për periudhën 2006 – 2007.

<sup>46</sup> Referojuni pyetësorit nr. 3, datë 27.5.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>47</sup> Me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 7.6.2019, në dosjen e Komisionit.

## **Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta**

17.7 Komisioni i ka kërkuar informacion edhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, lidhur me depozitim të kontratës, si dhe lidhur me pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara. Gjithashtu, Komisioni i ka kërkuar informacion edhe “C. A. A.”, si dhe “Credins Bank”.

17.8 Komisioni, nga analizimi i fakteve dhe rrethanave të përshkruara më sipër, lidhur me të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e pasurisë, mosdeklarimet e tyre, si dhe mungesa e dokumentacionit, konstatoi dhe për rrjedhojë i kaloi subjektit barrën<sup>48</sup> e provës pasi:

- i. dukej se kishte mospërputhje të vlerës së qirasë së deklaruar nga subjekti për vitet 2006 – 2007, në shumën 2 300 625 lekë dhe vlerës së përfituar në këto vite, në shumën 2 713 725 lekë;
- ii. dukej se nuk kishte deklaruar të ardhurat e përfituara nga qiraja për vitet 2006 – 2007, në shumën 413 100 lekë;
- iii. kishte mungesë të dokumentacionit justifikues mbi përfitimin e të ardhurave nga qiraja, në shumën 2 713 725 lekë, si kontrata e qirasë dhe pagesa e tatimit në burim për këto të ardhura dhe për pasojë i ka kaluar subjektit barrën e provës.

### **17.9 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni**

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet, e tij ka deklaruar se pagesa e shumës 413 100 lekë i referohet parapagesës së tre muajve të fundit të kohëzgjatjes faktike të kontratës së qirasë. Kontrata e qirasë ka qenë lidhur me afat 1-vjeçar dhe është rinovuar vetëm një herë, pasi personi që banonte në shtëpinë e marrë me qira nga “C. A. I.” u detyrua të largohet përpara kohe për arsye shëndetësore. Duke qenë se pagesa ishte kryer paradhënie, atëherë u diskutua mundësia e rikthimit të kësaj shume, pasi realisht banesa nuk u përdor më nga qiramarrësi “C. A. I.”. Megjithatë, kjo shumë nuk u kthye pasi u konsiderua si prishje e njëanshme e kontratës. Duke qenë në dilemën e kthimit ose jo të kësaj shume, ka ardhur edhe harresa e deklarimit si e ardhur në deklaratën periodike të vitit 2017. Kjo ka qenë arsyeja e vetme e mungesës së këtij deklarimi pasi ky mosdeklarim nuk do ishte në favorin e subjektit, përkundrazi kjo shumë do mund të përdorej për justifikimin e shpenzimeve të mundshme.

*“Gjithashtu, për vërtetimin e marrëdhënies së qirasë kemi kërkuar informacion edhe nga zyra e U. A.; subjekti ka depozituar përgjigjen e zyrës së U. A. . Gjithsesi, subjekti ka pretenduar se ekzistenca e marrëdhënies së qirasë është plotësisht e vërtetuar pasi të gjitha pagesat janë kryer nëpërmjet transfertave bankare, duke u shoqëruar edhe me përshkrimin e qëllimit të kryerjes së veprimit (që konkretisht është pagesë qiraje). Në kushtet e mungesës së kontratës së qirasë, ku siç kam deklaruar më parë, edhe mund të mos e kemi nënshkruar një të tillë, pasi afati i kontratës ka qenë një vit dhe më pas është rinovuar për një vit tjetër, mendoj se jemi përpara një prezumimi ligjor në favorin tim (pika 3, e nenit 49, e ligjit nr. 84/2016), sepse ligji i kohës ngarkonte qiramarrësin, në kushtet kur ai ishte subjekt juridik, me pagesën e tatimit që rridhte nga marrëdhënia e qirasë. Për këtë arsye, ky tatim quhet edhe tatimi në burim, pasi edhe mbahet nga shteti në burimin e krijimit të të ardhurave.”*

Subjekti ka depozituar kërkesë drejtuar zyrës së U. Tiranë, datë 8.7.2019 dhe përgjigje e U., datë 12.7.2019.

<sup>48</sup> Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, referoni rezultatet për specifikimet në detaje.



### **17.10 Vlerësimi i Komisionit**

Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit në raport me faktet e konstatuara, vëren se subjekti, sikurse është shprehur në pyetësorë edhe në prapësime: (i) nuk depozitoi kontratën e qirasë për të provuar detyrimet e ndërsjella të palëve qiradhënëse dhe qiramarrëse; (ii) nuk provoi me dokumentacion justifikues se marrëdhënia kontraktore ka qenë me një individ apo me një organizëm ndërkombëtar; (iii) pretendon se mosdeklarimi i shumës 413 100 lekë në deklaratën “Vetting” (si diferencë e konstatuar nga Komisioni, midis shumës reale të përfituar nga transaksionet bankare dhe asaj të deklaruar), është harresë si rezultat i dilemës që subjekti kishte pasur për kthimin ose jo të saj për arsye të largimit të qiramarrësit për shkaqe shëndetësore; (iv) konfirmimi në nivel zyrtar i organit tatimor se pranë tyre nuk administrohej informacion në lidhje me kontratën e qirasë ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe qiramarrësit “U. – C. A. I.”, si dhe pagesës së tatimit në burim për periudhën 2006 – 2007. Nga korrespondenca e mbajtur midis subjektit të rivlerësimit dhe zyrës së U.-it rezultoi se kjo e fundit nuk ka konfirmuar marrëdhënie qiraje në nivel organizmi, pra midis zyrës dhe subjektit, sikundër në përgjigjen e saj as edhe nuk mohon nëse ka pasur ndonjë të tillë me individ. Ky konfirmim përforcon faktin që, nëse marrëdhënia kontraktore ka qenë mes individësh, mungesa e pagimit të tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit e bën burimin e tyre tërësisht të paligjshëm. Në këto rrethana, trupi gjykues çmon se pretendimet e subjektit kanë mbetur tërësisht në nivel deklarativ, të pambështetura në prova dhe, për pasojë, arrin në konkluzion se subjekti:

- ✓ Ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën “Vetting”, në lidhje me të ardhurat reale të përfituara nga qiraja e banesës së tij për vitet 2006 – 2007, të konfirmuara sipas transaksioneve bankare në shumën 2 713 725 lekë, krahasimisht me ato të deklaruar në deklaratën “Vetting” në shumën 2 300 625 lekë.
- ✓ Nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor ligjshmërinë e burimit të të ardhurave nga qiraja për vitin 2006 dhe 2007, në shumën 2 713 725 lekë.

**Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.**

18. Në dosjen e ILDKPKI-së rezultoi e administruar një kontratë shitjeje automjeti me nr. (\*\*\*), datë 21.2.2007, sipas të cilës rezultonte se subjekti kishte shitur automjetin tip “Land Rover”, në shumën 500 000 lekë.

18.1 Nga hetimi rezultoi se subjekti nuk e kishte deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 shitjen e këtij automjeti, si dhe të ardhurat e përfituara prej tij.

18.2 Komisionit, kjo kontratë i rezultoi e administruar në praktikën e DPSHTRR-së<sup>49</sup>.

18.3 Komisioni, nga analizimi i fakteve dhe rrethanave të përshkruara më sipër, i rezultoi dhe, për pasojë, i kërkoi subjektit të japë shpjegime se:

- Dukej se subjekti nuk kishte deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie në vitin 2007, në shumën 500 000 lekë.

### **18.4 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni**

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka pretenduar se deklarimi i kësaj shitjeje nuk është pasqyruar prej tij në deklarimin periodik të vitit 2007, por është pasqyruar në deklaratën

<sup>49</sup> Referojuni shkresës nr(\*\*\*).prot., datë 16.5.2018, në dosjen e Komisionit.

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

“Vetting”. Subjekti është shprehur: “... nuk mendoj se mund të ketë pasur arsye specifike veç harresës, pasi edhe ky mosdeklarim mendoj se nuk mund të ishte në favorin tim.”

### **18.5 Vlerësimi i Komisionit**

- ✓ Trupi gjykues çmon se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, kohë në të cilën janë krijuar të ardhurat nga shitja e këtij automjeti.

19. Nga korrespondenca bankare me “Credins Bank”, rezultoi se djali i subjektit të rivlerësimit, J. K., ka marrë një kredi në datën 4.7.2012, në shumën 800,000 lekë.

19.1 Nga Hetimi, Komisionit i rezultoi se subjekti nuk e kishte deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 këtë kredi, qëllimin për të cilin ajo është marrë dhe as nuk kishte deklaruar më tej mbi shlyerjet e saj (përfunduar shlyerja në vitin 2014), dhe për këtë subjektit iu kërkua të japë shpjegime.

### **19.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni**

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka pretenduar se deklarimi i kësaj kredie nuk ishte pasqyruar nga prej tij në deklarinimin periodik të vitit 2012, por ishte pasqyruar në deklaratën “Vetting”. Subjekti është shprehur: “... nuk mendoj se mund të ketë pasur arsye specifike veç harresës.”

### **19.3 Vlerësimi i Komisionit**

- ✓ Trupi gjykues çmon se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, në lidhje me përfitimin e kredisë dhe shlyerjet e saj.

20. Komisionit, nga korrespondenca bankare me “Credins<sup>50</sup> Bank” i rezultoi se djali i subjektit, me cilësinë e personit të lidhur, kishte marrë një kredi në vitin 2011, në shumën 400 000 lekë.

20.1 Nga hetimi rezultoi se subjekti nuk e kishte deklaruar këtë kredi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 dhe më tej nuk kishte deklaruar as mbi shlyerjet e saj (përfunduar shlyerja në vitin 2012). Për këtë konstatim, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

### **20.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni**

Subjekti, në prapësimet e tij, ka pretenduar se deklarimi i kredisë nuk ishte pasqyruar prej tij, respektivisht në deklarinimin periodik të vitit 2011 dhe 2016, por ishte pasqyruar në deklaratën “Vetting”. Subjekti është shprehur: “... nuk mendoj se mund të ketë pasur arsye specifike veç harresës.”

### **20.3 Vlerësimi i Komisionit**

- ✓ Trupi gjykues çmon se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, në lidhje me përfitimin e kredisë dhe shlyerjet e saj.

21. Komisionit, nga korrespondenca bankare me “BKT”-në<sup>51</sup>, i rezultoi se djali i subjektit, me cilësinë e personit të lidhur, kishte marrë një kredi në vitin 2016, në shumën 250 000 lekë.

21.1 Nga hetimi rezultoi se subjekti nuk e kishte deklaruar këtë kredi në deklaratën për vitin 2016 (përfunduar shlyerja në vitin 2018<sup>52</sup>). Për këtë konstatim, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

<sup>50</sup> Referojuni të dhënave në metodologjinë Aneks, bashkëngjitur rezultateve të hetimit.

<sup>51</sup> Referojuni të dhënave në metodologjinë Aneks, bashkëngjitur rezultateve të hetimit.

<sup>52</sup> Duke iu referuar ndarjes nga trangu familjar të djalit të subjektit, këtij të fundit nuk i lindte detyrimi i deklarimit të shlyerjes së kredisë.

## *Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta*

### **21.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni**

Subjekti, në prapësimet e tij, edhe për këtë konstatim, ndër të tjera, është shprehur: “... *nuk mendoj se mund të ketë pasur arsye specifike veç harresës.*”

### **21.3 Vlerësimi i Komisionit**

- ✓ Trupi gjykues çmon se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, në lidhje me përfitimin e kredisë, në shumën 250 000 lekë.

Trupi gjykues, në prapësimet e subjektit, kryesisht lidhur me konstatimet e pasqyruara nën titullin “gjetje të tjera” ka vërejtur që subjekti, në mënyrë konsistente ka argumentuar se, konstatimet e Komisionit nuk mund të kenë pasur nga ana e tij, arsye specifike *veç harresës*. Trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht se kjo mënyrë argumentimi nuk është në standardet e nivelit të kërkuar për subjektet, objekt i ligjit nr. 84/2016, çmon se këto pasaktësi nuk kanë ndikuar në këtë vendimmarrje.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (referuar si DSIK), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte, nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës, me nr. (\*\*\*) prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 30.5.2018, për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar se:

- Nga hetimi nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

- Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, **DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Hysen Keta.**

- Komisioni, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016.

**Në përfundim të rivlerësimit për kontrollin e kriterit të figurës, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Keta, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.**

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

- Raporti i vlerësimit profesional është mbështetur në:

Formularin e vetëdeklarimit, tre dokumente ligjore të përzgjedhur nga subjekti i rivlerësimit, të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së, pas të cilit është konkluduar në:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

Raporti i vlerësimit profesional në analizë të gjetjeve<sup>53</sup>, si dhe bazuar në të gjitha burimet e informacioneve për subjektin e rivlerësimit, nuk ka evidentuar problematika në aspektin e aftësive profesionale, organizative, etikën dhe integritetin e subjektit.

### **C/1 RIVLERËSIMI PROFESIONAL**

Komisioni, pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale kryer nga KLP-ja, dhe dosjeve ku ishte bazuar ky raport, konstatoi se:

Për çështjen penale nr. 4, te katër dokumentet e përzgjedhur nga vetë subjekti që i përket vendimit për pushimin e ekzekutimit të vendimit penal “për shkak amnistie”, datë 30.9.2016, për të dënuarin E. S. dhe për çështjen penale nr. 3, në pesë dosjet e përzgjedhura me short, që i përket vendimit për pushimin e ekzekutimit të vendimit penal “për shkak amnistie”, datë 16.3.2016, për të dënuarin G. Gj., nuk ishin administruar vendimet e dënimit penal ndaj të pandehurve, të cilat iu kërkuan subjektit. Subjekti depozitoi<sup>54</sup> vendimet penale, nga analizimi i të cilëve, sikurse dhe subjekti ka sqaruar<sup>55</sup>, rezultoi se në vendimmarrje subjekti i rivlerësimit ishte bazuar në germën “b”, të nenit 3, të ligjit “Për amnistinë”, pasi në të dy rastet dënimi i formës së prerë ishte dhënë me alternativë dënimi.

Trupi gjykues:

- ✓ Në analizë të fakteve dhe provave të depozituara nga subjekti në të dy rastet e vendimmarrjeve çmon se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore mbi përfitimin e amnistisë.

**Në vlerësimin profesional u shqyrtua edhe dosja penale që i përket procedimit penal nr. (\*\*\*) , datë 28.2.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.**

Komisioni, me shkresën nr. (\*\*\*) prot., datë 14.1.2019, ka administruar dosjen e këtij procedimi penal.

### **Hyrje**

Procedimi penal, nr. (\*\*\*) , datë 28.2.2017, është regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Përmet pas kallëzimit penal nga ILDKPKI-ja me pretendime kundër shtetasit G. L. (në atë kohë doganier në zyrën doganore “T. U.” Përmet) për veprat penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehje ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”

<sup>53</sup> Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

<sup>54</sup> Referojuni *e-mail*-it datë 21.6.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>55</sup> Referojuni pyetësorit datë 24.6.2019 (tekst në *e-mail*), në dosjen e Komisionit.

## Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta

dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuara përkatësisht nga nenet 257/a/2 dhe 287 të Kodit Penal. Rezulton se dosja është hetuar nga prokurorët A. B. dhe H. Keta.

### Kallëzimi penal nga ILDKPKI

Në datën 24.2.2017, ILDKPKI-ja ka depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet një kallëzim penal kundër shtetasit G. L., subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së, për shkak të detyrës si doganier në zyrën doganore “T. U.”, Përmet. Në tërësi është konstatuar moskryerja e disa veprimeve hetimore kryesisht për sa i përket provueshmërisë së kryerjes së veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, ose veprimtarisë kriminale. ILDKPKI-ja, në bazë të nenit 281<sup>56</sup> të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar fillimin e procedimit penal ndaj G. L., për veprat penale të parashikuara nga nenet 257/a/2<sup>57</sup> dhe 287<sup>58</sup> të Kodit Penal (gjithashtu duke i kërkuar prokurorisë të marrë në konsideratë çdo vepër tjetër penale të lidhur).

Ata i kanë bashkëngjitur kallëzimit kopje të deklaratave vjetore dhe të dhënave/dokumenteve të tjera të mbledhura gjatë gjithë procesit hetimor<sup>59</sup>.

### Veprimet hetimore dhe vendimet e prokurorit në datën 28.2.2017

Prokurori i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Përmet, z. A. B., ka regjistruar procedimin penal sipas neneve 287/1<sup>60</sup> dhe 315/3<sup>61</sup> të Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit G. L., për veprën penale të parashikuar nga nen 257/a<sup>62</sup> i Kodit Penal.<sup>63</sup>

Në datën 10.3.2017, prokurori A. B. ka nxjerrë urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore.<sup>64</sup>

<sup>56</sup> Neni 281 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: **Neni 281 Kallëzimi nga nëpunësit publikë 1.** Nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dënimin për një vepër penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale. 2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore.

3. Kur, gjatë një procedimi civil ose administrativ, zbulohet një fakt që përbën vepër penale që ndiqet kryesisht, organi përkatës bën kallëzim të prokurorit. 4. Kallëzimi përmban elementet thelbësore të faktit, burimet e provës, gjeneralitetet, banimin dhe çdo gjë tjetër që vlen për identifikimin e personit të cilit i atribuohet fakti, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të sqarojnë rrethanat e faktit.

<sup>57</sup> Neni 257/a/2 i Kodit Penal parashikon si vijon: **Neni 257/a Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim.** Refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimi i pasurisë, interesave privatë të personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj. **Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.**

<sup>58</sup> Neni 287 i Kodit Penal parashikon se: **Neni Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale** Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet: a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transakcioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave; d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale; dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; - dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur: a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet; b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashikuar ose amnistuar; c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjti me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet; ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë; d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë. Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.

<sup>59</sup> Dokumentet e përfshira: korrespondenca e ILDKPKI-së me “Raiffesien Bank” e vitit 2016, dhe gjithë deklaratimet periodike të të akuzuarit.

<sup>60</sup> Pika 1, e nenit 287, të Kodit të Procedurës Penale parashikon: “1. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.”

<sup>61</sup> Pika 3, e nenit 315, të Kodit të Procedurës Penale parashikon: “3. Akti që përmban marrjen në dënim për veprën penale dhe dokumentacioni që lidhet me hetimet, si urdhrat e porositë për policinë gjyqësore, kërkesat drejtuar gjykatës, njoftimet etj. ruhen në një fashikull të posaçëm në sekretarinë e prokurorisë së bashku me aktet e ardhura nga policia gjyqësore”.

<sup>62</sup> Refuzimi për deklarim, mosdeklarim, fshehjen ose deklarim i pavërtetë i aseteve/pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose të çdo personi tjetër që ka detyrim ligjor për deklarim. Shihni shënimin 2 më lart.

<sup>63</sup> Urdhri i prokurorit për regjistrimin e procedimit penal dhe emrin e personit të cilit i është referuar vepra penale, pjesë e dosjes.

<sup>64</sup> Urdhri i prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore, pjesë e dosjes.

## *Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta*

Prokurori ka urdhëruar oficerin e policisë gjyqësore, z. A. N., që brenda datës 20.4.2017 të kryente veprimet hetimore, si në vijim:

- të kërkonte nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë informacione për të dyshuarin dhe bashkëshorten nëse ishin regjistruar si tatimpagues dhe nëse ushtronin veprimtari/aktivitet tregtar në Vlorë, dhe, nëse po, të administrohej dokumentacioni përkatës;
- të kërkonte nga Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor të Vlorës informacion nëse nga viti 2006 dhe në vazhdim, i dyshuari dhe/ose bashkëshortja të kishin regjistruar automjete si pronarë ose bashkëpronarë dhe, nëse po, të administrohej dokumentacioni përkatës;
- të inspektonte të dhënat e *TIMS* për të dyshuarin;
- të kërkonte nga drejtoria e ALUIZNI-t Vlorë nëse i dyshuari dhe/apo bashkëshortja kishin aplikuar ndonjëherë për legalizim të ndërtimeve joformale ose nëse ju ishte lëshuar leje legalizimi;
- të kërkonte nga bankat e nivelit të dytë informacion për çdo llogari, kredi dhe çdo veprimtari tjetër bankare nga i dyshuari dhe bashkëshortja;
- të kërkonte informacione nëse i dyshuari dhe bashkëshortja kishin pasuri të paluajtshme të regjistruara në emrat e tyre (si pronarë ose bashkëpronarë) ose të drejta të tjera pronësore;
- të thërriste dhe të merrte në pyetje të dyshuarit për identitetin e individëve të cilëve ai i kishte dhënë shumën 70 000 euro, për kushtet e këtij borxhi, për statusin aktual, si dhe rezultatet e verifikimit të pasurisë së të dyshuarit dhe të anëtarëve të familjes së tij;
- të thërriste dhe të pyeste, pas identifikimit, individët që i kishin marrë para borxh të dyshuarit.

Në varësi të kërkimeve për t'u kryer veprimet hetimore, fakteve për të cilat është referuar dhe më tej regjistruar procedimi penal, Komisioni ka konstatuar dhe, për pasojë, i ka kaluar subjektit barrën e provës pasi duket se:

- nuk ishte kërkuar kryerja e veprimeve hetimore në lidhje me legjitimitetin e të ardhurave nga puna në emigracion e pretenduar nga subjekti deklarues, nisur kjo më së tepërmi edhe nga kallëzimi i bërë edhe për kryerje të veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale;
- nuk ishte kërkuar kryerja e veprimeve hetimore në lidhje me veprimtari të mundshme kriminale të të dyshuarit ose personave që kryejnë transaksione parash me të;
- nuk ishte kërkuar kryerja e veprimeve hetimore lidhur me komunikimin me autoritetet e huaja shtetërore;
- kishte mungesë të theksuar të hetimeve të kryera ndaj të dyshuarit (subjektit deklarues). Ai ishte pyetur vetëm lidhur me punët e kryera dhe me qëndrimet e tij jashtë vendit. Madje, kishte përfunduar dëshmitë e tij me pretendimin se përderisa ishte inspektuar një herë nga ILDKPKI-ja çështja penale nuk ekzistonte, pasi ishte mbi të njëjtat fakte;
- nuk rezultonte të kishte pasur pyetje apo sqarime të mëtejshme për/nga i dyshuari;
- oficeri i policisë gjyqësore mund të kishte/dhe duhet të kishte bërë më shumë pyetje që mund të ndihmonin në sqarimin e akuzave ndaj tij. Për shembull, të dyshuarit mund t'i ishin kërkuar më shume detaje për punën e tij jashtë vendit, siç ishte koha, vendi, vendndodhja, punëdhënësi, kontaktet, paga/të ardhurat e bëra dhe nëse ai mund të siguronte dokumentacion mbështetës. Mund t'i kërkohej të kishte dhënë detaje të mëtejshme mbi aktivitetin/biznesin e tij në Shqipëri. Atij mund t'i kërkohej të kishte dhënë detaje mbi huan që u kishte dhënë kushërinjve të tij, pritshmërive për ta marrë atë mbrapa (kur e pret këtë gjë) dhe detaje mbi punën që bënin kushërinjtë e tij;
- nga dokumentacioni i administruar nuk rezultonte të ishte ndërmarrë ndonjë veprim hetimor mbi punën e të dyshuarit në Gjermani dhe në Greqi;
- dokumentet e administruara nuk ishin të mjaftueshme për të ndihmuar prokurorinë të arrinte në konkluzion/përfundim në lidhje me akuzat. Nuk kishte informacion, dokument, apo ndonjë veprim/hap hetimor mbi punën e tij;

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

- nuk rezulton të ishte hetuar mbi gjendjen e tij gjyqësore;
- nuk rezultonte të ishte marrë ndonjë veprim hetimor lidhur me faktin nëse nga i dyshuari apo kushërinj të tij, të cilët kishin marrë hua, të ishin ndjekur penalisht apo për ta të kishte pasur hetime të mëparshme brenda dhe jashtë vendit;
- nuk ishte hetuar thellësisht dhe në mënyrë të plotë lidhur me huat e marra nga shtetasit L., shlyerjen e tyre, etj.;
- nga informacionet apo korrespondencat me autoritetet zyrtare (QKB, DRT, ZVRPP, etj.), përgjigjet kishin pasqyruar të dhëna lidhur me punësimet, regjistrimet e bizneseve, vetëm pas vitit 2006 e në vijim, për të dyshuarin dhe bashkëshorten e tij. Në të tilla kushte nuk rezultonte që hetimi të ishte shtrirë përpara vitit 2006, kohë në të cilën datonte më së shumti vënia e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme;
- nuk rezultonte të ishte shtrirë kryerja e veprimeve hetimore lidhur me mënyrën e fitimit të pasurive, megjithëse ishin trajtuar si të përfituara nga legjislacioni në fuqi, si ai i kthimit dhe kompensimit të pronave, etj.;
- nuk rezultonte që të ishin kryer veprime hetimore të mëtejshme në sistemin *TIMS* lidhur me lëvizjen jashtë vendit të njërit prej huamarrësve, shtetasit A. L., por për këtë shtetas prokuroria ishte mjaftuar vetëm me një administrim të shkresës së *TIMS-it* e cila pasqyronte vetëm kokën e dokumentit dhe asgjë më shumë;
- nuk rezultonte të ishte hetuar në lidhje me çështjen e huas dhënë shtetasve L. L. dhe A. L.;
- nuk rezultonte të ishin kryer hetime në të gjithë sistemin bankar, por vetëm në një bankë, konkretisht në “Raiffeisen Bank”;
- nuk rezultonte të ishin shtrirë hetimet lidhur me faktin nëse në emër të shtetasit L. L. rezultonin të regjistruara pasuri të paluajtshme;
- në tërësi konstatohet njëanshmëri e plotë në kryerjen e hetimeve;
- në dosje thuhej që është thirrur një ekspert për të kryer aktin e ekspertimit financiar, ndërsa nuk tregohet nëse ky person ka qenë i licencuar, nëse ka bërë betimin për kryerjen e këtij akti dhe për më tepër në dosje nuk ishte administruar asnjë akt i tillë;
- në datën 9.11.2017, oficeri i policisë gjyqësore kishte përfunduar relacionin e tij në lidhje me ndjekjen penale nr. (\*\*\*)/2007, duke i rekomanduar prokurorit Hysen Keta përfundimin e hetimeve, me konkluzionin për mungesë lidhjeje të deklarimeve të pasakta për qëllime kriminale. Sa për origjinën e parave dhe pasurive, duke i konsideruar veprimet hetimore të plota, ishte arritur në konkluzionin se ai i kishte përftuar ato nga punësimi në Shqipëri dhe jashtë shtetit, përpara se të merrte detyrën, në një ekonomi informale si kjo jona, dhe se origjina nuk mund të vërtetohet;
- ndonëse disa nga shpjegimet mund të qëndrojnë logjikisht, porë nga këndvështrimi i detyrimit administrativ për të bërë deklaram përpara ILDKPKI-së, konstatohet se ato nuk qëndrojnë kur bëhet fjalë për një hetim penal për vepra penale si ajo e “pastrimit të produkteve...”, që nuk lidhet me ndonjë detyrë;
- nuk ishte kryer ndonjë hetim i plotë në elementët potencialë të kësaj vepre penale dhe nuk kishte shpjegime se përse nuk ka qenë e nevojshme të bëhej një gjë e tillë;
- pasi hetimet janë zgjatur hetimet me vendimet përkatëse, përkatësisht nga data 29.5.2017 – 28.8.2017 dhe 29.8.2017 – 28.11.2017, në datën 12.11.2017 prokurori Hysen Keta ka njoftuar ILDKPKI-në dhe personin e dyshuar mbi mbylljen e hetimeve për veprat penale të parashikuara nga nenet 257/a/2 dhe 287 të Kodit Penal;
- në arsyetimin e këtij vendimi arsyetohet mbi deklaramet e pasakta në deklaratën e marrjes së detyrës nga i dyshuari në ILDKPKI, mbi faktin që ILDKPKI-ja nuk ka bërë asgjë, ndonëse ka kryer një kontroll të plotë në vitin 2012;
- në vendim nuk ka analizë të elementëve të veprave penale, përse ato nuk ekzistojnë/nuk mund të provohen dhe si mbështetet një konkluzion i tillë me provat e mbledhura;

## **Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta**

- në vendim, si pasojë e moskryerjes së veprimeve hetimore, vepra penale e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (pastrim parash) neglizhohet krejtësisht/nuk jepet asnjë argument;
- dosja përmban një kërkesë (pa datë) të bërë nga prokurori Hysen Keta drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet për mbylljen e çështjes;
- baza ligjore e identifikuar përbëhet nga neni 328/1 shkronjat “b” dhe “dh”<sup>65</sup>, si dhe neni 329/a<sup>66</sup> i Kodit të Procedurës Penale. Argumentet janë po të njëjtat si më sipër.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni**

Për sa i përket procedimit penal nr. (\*\*\*) të vitit 2017, subjekti, ndër të tjera, ka cituar: ... ky procedim është regjistruar në datën 28.2.2017, nga prokurori A. B., për veprat penale “refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” dhe “pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 257/a/2 dhe 287 të Kodit Penal. Pas komandimit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Përmet ka marrë për veprim këtë çështje, ashtu si dhe çështjet e tjera që i ka dorëzuar prokurori i mëparshëm për shkak të komandimit të tij në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier. Nga studimi i materialeve të këtij procedimi penal subjekti është shprehur: *“...konstatova se urdhri për kryerjen e veprimeve hetimore të deleguara oficerit të policisë gjyqësore, përmbante të gjitha veprimet e mundshme hetimore që duheshin kryer për të sqaruar rrethanat e parashtruara në kallëzimin penal të paraqitur nga ana e ILDKPKI-së, për subjektin e kallëzuar G. L., si dhe ish-in dërguar shkresat për kërkimin e informacioneve nga institucionet, ndaj dhe detyra kryesore që mbetej ish-in ndjekja në vazhdimësi e kryerjes së veprimeve të deleguara. Në analizën përfundimtare të procesit rezultoi se për veprën penale të pastrimit të produkteve të parashikuar nga neni 287, nga ana e personit nën hetim ishin dhënë deklarime në të cilat sqaronte se kishte punuar në emigracion në shtetin grek, Gjermani dhe për një periudhë më të gjatë kohe në Itali, duke paraqitur edhe dokumente justifikuese si, librezën e punës të lëshuar nga ministria e punës të atij shteti, pasaportën me vulat hyrëse e dalëse, lejen e qëndrimit në Itali si dhe disa fotografi në vendin e punës, dokumente këto të administruara nga faqja 219-245 të dosjes hetimore... Subjekti është shprehur se: ... shtetasi në hetim, në lidhje me shumën 70 000 euro ka deklaruar se nuk ka dokument zyrtar për dhënien e huas nisur nga marrëdhëniet që ka me ta, (kushëri të parë) duke mos dashur të tregojë mungesë besimi ndaj tyre. Sidoqoftë, nga hetimet e zhvilluara nuk rezultoi shlyerja e këtij borxhi prej tyre deri në fazën që janë zhvilluar hetime dhe nga personi në hetim nuk është pretenduar kthimi i kësaj shume apo vënia në përdorim e kësaj shume ose të ndonjë shume të përafërt me të për kryerje transaksionesh. Sidoqoftë, hetimet u shtrinë edhe në drejtim të verifikimit të pasurive të të dy këtyre shtetasve L. dhe A. L., duke u kërkuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, nga drejtoria rajonale e shërbimit të transportit rrugor, dhe bankat për posedim pronash, automjetesh apo llogarish bankare nga ana e këtyre dy shtetasve, përgjigje të cilat rezultuan negative. Pra, fakti që shuma prej 70 000 eurosh nuk rezultoi të jetë përdorur, këmbyer, transferuar apo fituar pronësi, si nga ana e personit nën hetim ashtu edhe nga personat në emër të të cilëve pretendohet se është dhënë kjo hua,*

<sup>65</sup> Neni 328, pushimi i akuzës ose çështjes (ndryshuar me ligjin nr. 8460, datë 11.2.1999, neni 4) (ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, neni 182): “1. Në përfundim të hetimeve paraprahe, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: a) del qartë se fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) viktimi nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdojë; dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet se e ka kryer ai; e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale; ë) i pandehuri vdes; f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj.”

<sup>66</sup> Neni 329/a, kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes (shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, neni 184). “1. Në përfundim të hetimeve paraprahe, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprahe pushimin e akuzës ose çështjes.”



## **Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta**

*shërbejnë si një e dhënë e rëndësishme në drejtim të mungesës së elementëve të anës objektive të kryerjes së veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Në këto kushte e vetmja shumë reale e cila duhet të shërbente si objekt i hetimit të mëtejshëm në ngarkim të personit nën hetim për këtë vepër penale, mbetej ajo prej 10 000 eurosh, e cila është depozituar në banke dhe ishte deklaruar prej personit nën hetim në deklarimin fillestar të pasurisë në vitin 2006... nga ana jonë ju kërkua gjykatës pushimi i hetimeve për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, me vendimi nr. (\*\*\*), datë 7.12.2017, është vendosur pranimi i kërkesës tonë për pushimin e çështjes. Për sa i përket veprave të tjera penale për të cilat personi nën hetim ishte kallëzuar nga ILDKPKI, si refuzimi për deklarim, mos deklarimi fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private, të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin për të deklaruar, sipas nenit 257/a të Kodit Penal, nga ana jonë u kryen hetime nga rezultoi se në rastin konkret nuk ndodheshim para kësaj vepre penale, pasi personi nën hetim, si subjekt i deklarimit të pasurive, kishte deklaruar pasurinë si në momentin fillestar kur kishte filluar punë në vitin 2006 ashtu edhe në vazhdim. Pasaktësitë e vërejtura në procesverbalet e deklarimit të pasurive ishin verifikuar edhe më parë nga ILDKPKI, dhe ishin konsideruar si gabime njerëzore përdërisa në vitin 2012 ndaj tij ILDKPKI nuk kishte bërë kallëzim penal. Ky fakt i deklaruar nga personi nën hetim rezultoi i konfirmuar nga procesverbali mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive, i datës 18.09.2012, i administruar në dosjen hetimore (faqe 176-179). Në këto rrethana, nga ana jonë, gjetja e ILDKPKI-së u konsiderua si ‘gjë e gjykuar’ dhe duke mos konstatuar fakte apo rrethana të tjera të dyshimta në lidhje me këtë akuzë i kërkua gjykatës pushimin e çështjes, kërkesë e cila u pranua prej saj me vendimin e mësipërm, i cili ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar nga enti kallëzues.”*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar në fashikullin hetimor, vëren se subjekti nuk arriti të provojë se ka kryer veprime hetimore të thelluara lidhur me legjitimitetin e të ardhurave të pretenduara nga subjekti deklarues, nga puna në emigracion, por është mjaftuar me deklaratimet e të akuzuarit mbi punësimin e tij në disa shtete jashtë vendit, apo mbi disa prova të depozituara, si librezë punësimi, pasaportë, leje qëndrimi në Itali, apo disa fotografi në vendin e punës në shtetin italian. Subjekti nuk provoi të kishte hetuar lidhur me pretendimet e subjektit deklarues se kishte punuar në shtetin grek dhe atë gjerman. Fakti që nga shuma e pretenduar 80 000 euro, si e fituar nga puna në emigracion, rezultoi në depozituara me transaksion bankar vetëm 10 000 prej tyre dhe për shumën 70 000 euro e pretenduar si e dhënë hua, nuk kishte gjurmë apo nuk provohej me dokumente justifikuese, duhet ta çonte subjektin e rivlerësimit në dyshime të arsyeshme për burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, dhe për pasojë duhet ta vinte atë në pozita të tjera vendimmarrjeje për të hetuar, përtej veprimeve të kryera rutinë, të cilat subjekti i konsideron të mjaftueshme.

Subjekti nuk provoi se kishte hetuar në lidhje me veprimtari të mundshme kriminale të të dyshuarit ose personave që kryejnë transaksione parash me të, nuk provoi mbi komunikime të mbajtura me autoritetet e huaja shtetërore.

Trupi gjykues çmon se ka qenë detyrë parësore e subjektit të rivlerësimit të hetonte mbi gjendjen gjyqësore të të akuzuarit, veprim të cilin e ka anashkaluar. I njëjti veprim hetimor duhej të kryhej edhe në lidhje me personat e pretenduar nga i akuzuari se shuma 70 000 euro i ishte dhënë hua. Edhe në këtë rast subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kishte hetuar mbi gjendjen gjyqësore të tyre brenda dhe jashtë vendit. Po ashtu, subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor, legjitimitetin e ekspertit të thirrur për të kryer aktin e ekspertimit

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

financiar, si dhe vijimin e procedurës për kryerjen e betimit, për të realizuar një aktekspertim në përputhje me ligjin dhe kërkesat e vëna në dispozicion për zgjidhje.

Në tërësi subjekti nuk provoi mbi administrimin e këtyre provave në fashikullin hetimor. Gjithashtu, subjekti nuk ka parashtuar asnjë fakt reagues lidhur me atë çfarë kishte sugjeruar në relacionin e tij OPGJ-ja, kur ndër të tjera, anashkalonte hetimin mbi origjinën e parave dhe pasurive, por konsideronte veprimet hetimore të plota.

- ✓ Në tërësi në këtë çështje penale, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementët e veprave penale se përse ato nuk ekzistojnë, përse nuk mund të provohen dhe se si është arritur në një konkluzion të tillë me provat e mbledhura.
- ✓ Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për legjitimitetin e të ardhurave të pretenduara nga i akuzuari se janë fituar nga puna në emigracion, në përputhje me pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

### **MBI DENONCIMET E PARAQITURA NË KOMISION PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT**

Në lidhje me shtatë<sup>67</sup> denoncimet e depozituara në Komision, bazuar në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016, u kërkua edhe opinionin e KLP-së<sup>68</sup>. Komisioni, në analizë të opinionit të dhënë, pasi shqyrtoi përmbajtjet dhe provat shoqëruese të tyre, sikurse ishte shprehur edhe KLP-ja, në lidhje me gjashtë prej tyre, konstatoi se nuk përmbaheshin fakte dhe rrethana që të mund të konsideroheshin në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, ndërsa për dy<sup>69</sup> denoncimet e tjera, të cilat i përkisnin të njëjtit denoncues dhe të njëjtit objekt ankimi, Komisioni hetoi dhe i rezultoi si vijon:

#### **➤ Denoncim i shtetases (J. J.)**

Denoncuesja ankohet për zvarritje të procesit hetimor ndaj procedimit penal nr. 43, datë 23.4.2018, të nisur ndaj ekspertit Xh. Ll., kallëzuar për ekspertim të rremë, për të cilin subjekti (pretendon ajo) në datën 7.6.2019, ka vendosur pushimin e tij/procedimit. Në denoncim, ndër të tjera, subjekti ka informuar se për rastin në fjalë është zhvilluar edhe një gjyq civil për çështje pronësie. Pra, duket se çështja penale ka qenë e ndërthurur me një çështje civile pronësore dhe njëkohësisht e trajtuar edhe në rrugë gjyqësore.

Për sa i përket zvarritjes së hetimit të procedimit penal<sup>70</sup>, KLP-ja në analizimin e saj ka pasqyruar faktin se në fashikullin penal është depozituar një kërkesë e denoncueses në datën 6.8.2018, sipas të cilës është kërkuar informacion lidhur me hetimet e kryera nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, pas të cilës, nuk ka rezultuar të ketë kthim përgjigje.

Komisioni, pasi ka verifikuar fashikullin penal të përcjellë nga KLP-ja, ka konstatuar, dhe për këtë i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime pasi dukej se:

- çështja penale është regjistruar në datën 23.4.2018, bazuar në urdhrin e subjektit të rivlerësimit për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “ekspertim i rremë”, pa përcaktuar autor të veprës penale, ndërsa mbi kallëzimin e depozituar denoncuesja ka kallëzuar konkretisht individin me cilësinë e ekspertit topograf dhe ka qartësuar pretendimet në lidhje me aktin e ekspertimit;

<sup>67</sup> Denoncim i shtetases (Y. P.); denoncimi i shtetasit (K. H.); denoncimi i shtetasit (Sh. H.); denoncim i shtetasit (R. O.); denoncimi shtetasit (E. Sh.).

<sup>68</sup> Referojuni informacionit të dhënë bashkëngjitur shkresës nr. (\*\*\*) prot., datë 27.6.2019, të KLP-së, në dosjen e Komisionit.

<sup>69</sup> Shkresa nr. (\*\*\*) prot., datë 29.1.2019, dhe nr. (\*\*\*) prot., datë 17.6.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>70</sup> Referojuni informacionit të dhënë bashkëngjitur shkresës nr. (\*\*\*) prot., datë 27.6.2019, të KLP-së, në dosjen e Komisionit.

## **Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta**

- ndryshe nga sa sipër, në kërkesën nr. (\*\*\*) prot., datë 10.5.2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, f. 14 në fashikull, subjekti kishte cituar se çështja penale është regjistruar në ngarkim të shtetasit Xh. Ll. . Rezultoi se akti i ekspertimit ishte përgatitur nga ky ekspert në datën 30.03.2018, akt i hartuar përpara kallëzimit të denoncues;
- në fashikull nuk rezultoi të jenë kryer veprime hetimore lidhur me kohëzgjatjen e kësaj çështjeje për të cilën subjekti kishte përfunduar hetimet vetëm në datën 7.6.2019;
- në fashikull nuk rezultoi të jetë thirrur për t'u pyetur kallëzuesja;
- me procesverbalin datë 30.5.2019, thuajse pas një viti nga regjistrimi i procedimit penal, është thirrur dhe pyetur i kallëzuari;
- përfundimi i hetimeve u është njoftuar në datën 7.6.2019 kallëzuesve dhe të kallëzuarit;
- sikurse është shprehur edhe KLP-ja në informacionin e tij, në fashikull nuk është administruar<sup>71</sup> kthim përgjigjeje mbi kërkesën e kallëzueses, datë 6.8.2019, lidhur me ecurinë e hetimeve të procedimit penal.

### **➤ Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni**

Subjekti, ndër të tjera, është shprehur: “...për sa i përket procedimit penal nr. 43 të vitit 2018, sqaroj se ky procedim është filluar mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shtetasit A. J., J. J., etj., që bënte fjalë për veprën penale të ‘ekspertimit të rremë’, parashikuar nga neni 309 të Kodit Penal. Në lidhje me konstatimin, se në regjistrin e prokurorit nuk është regjistruar emri i personit të denoncuar Xh. Ll., kjo ka ndodhur për arsye se është ndjekur praktika e punës në institucionin e prokurorisë në përgjithësi, që jo për çdo rast përmendja e emrit të një personi në kallëzim të shërbente si shkak për regjistrimin e emrit të tij në regjistër. Kjo praktikë ka qenë e bazuar edhe në një udhëzim të prokurorit të përgjithshëm, me nr. 241, të datës 21.11.2005, ‘Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale’ në pikën 3.1, të të cilit thuhet, ndërmjet të tjerash, ‘...përmendja e emrit të një personi në një kallëzim nuk mund të shërbeje për regjistrimin e menjëhershëm të emrit në regjistër, pa u administruar më parë akte procedurale, në të cilat gjenden atribuime për personin konkret’ ... Për hetimin e kësaj çështjeje u administruan materialet e dosjes civile në gjykim, nga rezultoi se nga ana e kallëzuesve ky pretendim ishte ngritur para gjykatës, e cila me vendim të ndërmjetëm e kishte rrëzuar atë. Pas këtij vendimi të gjykatës nga ana e palës së paditur u bë kallëzim penal në prokurori, duke pretenduar se ishte kryer ekspertim i rremë. Rrethanat tregonin se ky veprim i tyre ishte bërë për të përfutur sa më shumë kohë dhe ky fakt rezultoi edhe nga kërkesa që ata bënë menjëherë pas regjistrimit të çështjes, duke kërkuar në gjykatë pezullimin e gjykimin civil deri në zgjidhjen e çështjes penale. Ky pretendim i tyre u rrëzua gjithashtu me vendim nga ana e gjykatës civile, e cila vendosi mospranimin e kërkesës për pezullimin e gjykimin, bazuar në nenin 297, germa ‘a’ e Kodit të Procedurës Civile duke vlerësuar se çështja civile mund të zgjidhet para zgjidhjes së çështjes penale. Për më tepër, duke qenë se pretendimi për ekspertim të rremë nuk lidhej me rrethana objektive të çështjes, e kam menduar si të ligjshme pritjen e zgjidhjes që do të bënte gjykata, e cila kishte detyrimin të vlerësonte pretendimet e palëve në proces, përfshirë dhe vlerësimin e aktit të ekspertimit dhe konkluzioneve të tij. (nenet 228, 229 të Kodit të Procedurës Civile). Pikërisht ky është shkaku kryesor që çoi në mbajtjen e çështjes në hetim për një kohë relativisht të gjatë. Për sa i përket konstatimit për mosadministrimin e kthimit të përgjigjes mbi kërkesën e kallëzueses të datës 6.8.2018, ju sqaroj se përgjigja për kërkesën lidhur me ecurinë e hetimeve të procedimit penal i është kthyer si në këtë rast, ashtu edhe në raste të tjera, K. J., A. J., të cilët herë pas here kanë ardhur për t'u interesuar në prokurori.”

<sup>71</sup>Neni 110 i Kodit të Procedurës Penale; memoriet dhe kërkesat e palëve/ 1. Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim/ 2. Organi procedurës shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve.

## *Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta*

### ➤ **Vlerësimi i Komisionit**

Trupi gjykues, në analizë të akteve të administruara në fashikullin hetimor dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, konstaton se subjekti nuk arriti të provojë me besueshmëri ligjore regjistrimin e kallëzimit pa autor, në një kohë që kallëzimi ka qenë konkret me autor dhe me akuzë të bazuar në ligj. Subjekti synon ta vendosë këtë gjetje në kuadrin e praktikës së mbajtur në organin e prokurorisë, ndërsa nga ana tjetër ka ndërmarrë veprime edhe pranë organit të gjyqësorit, duke përmendur emrin e të kallëzuarit në kërkimet e tij. Subjekti, edhe kohëzgjatjen e hetimeve e përzien me procedurat civile që zhvilloheshin në gjykatë lidhur me këtë çështje. Subjekti synon të argumentojë zgjatjen e hetimeve, për shkak të zhvillimit të procesit gjyqësor civil në gjykatë për të njëjtën çështje, pra, duke e parë pozicionin e tij të ndërvarur nga procesi civil, në pritje të asaj se çfarë do të ndodhte në gjyqësor që më pas ai të hetonte lidhur me kallëzimin, ndërsa vetë gjyqësori nuk e ka quajtur të lidhur çështjen civile me atë penale duke mos pranuar pezullimin e procesit. Përkundrazi, ky fakt duhet të inkurajonte subjektin në vazhdimin e hetimeve, të mos i zgjaste ato pa arsye ligjore. Subjekti pretendon se fakti që në gjykatë kishte një vendimmarrje të ndërmjetme për ekspertim të rremë, atëherë ky ishte një tjetër argument ku subjekti mund të bazohet dhe të mos vijonte hetimin e mëtejshëm. Mënyra se si synon të argumentojë subjekti i rivlerësimit moskryerjen e veprimeve hetimore të konstatuara nga trupi gjykues, duket paragjyqese. Gjithashtu, subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues mbajtjen e korrespondencës me kallëzuesit të cilët kishin shprehur disa herë interesimin e tyre pranë organit të prokurorisë lidhur me ecurinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Subjekti pretendon se përgjigja për kërkesën lidhur me ecurinë e hetimeve të procedimit penal i është kthyer, si në këtë rast, ashtu edhe në raste të tjera shtetasve K. J., A. J., të cilët herë pas here kanë ardhur për t'u interesuar në prokurori, por për këtë fakt nuk depozitoi dokumente.

- ✓ Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për të provuar akuzën e ngritur nga denoncuesi për kryerje të ekspertimit të rremë nga shtetasi Xh. Ll. në një proces civil pronësie, në përputhje me pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.
- ✓ Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim edhe me pikën 4, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, pasi ka zgjatur afatin e hetimit të procedimit penal nën argumentin e pritjes së përfundimit të procesit gjyqësor civil të pronësisë, proces i vënë në lëvizje nga denoncuesit, në një kohë që duhet të hetonte krejtësisht në mënyrë të pavarur kallëzimin penal.

**Lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues, në referim të dispozitave të sipërcituara, çmon se sipas kriterëve të parashikuara në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, në procedimin penal nr. (\*\*\*), datë 28.2.2017, si dhe në rastin e denoncueses J. J., subjekti paraqet mangësi në drejtim të kryerjes së veprime hetimore të arsyetuara më sipër.**

**Në konkluzion, pas rekomandimit të relatorit të çështjes, në vlerësimin tërësor të tyre, trupi gjykues çmon se këto mangësi nuk janë të mjaftueshme për ta kualifikuar subjektin e rivlerësimit në mospërmbushje të nivelit minimal kualifikues dhe për pasojë, vlerësohet se subjekti ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.**

### **VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

**A. Trupi gjykues, lidhur me kriterin e pasurisë, çmon se:**

Për pasurinë e identifikuar me nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me vlerën reale të kostove të ndërtimit; nuk ka pasur aftësi financiare në shumën

## ***Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin Hysen Keta***

3 016 117 lekë (sipas përlogaritjeve të kryera me çmimet e EKB-së), për të investuar në ndërtimin e kësaj pasurie të paluajtshme përgjatë viteve 1996 – 1998, si dhe për të përballuar shpenzimet familjare; nuk ka provuar me dokumentacion ligjor burimet e ligjshme nga ushtrimi i profesionit të avokatit; si dhe ka kryer deklaram të pasaktë të përfitimit të pasurinë truall.

Për pasurinë e identifikuar me nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me vlerën reale të kostove të ndërtimit; nuk ka pasur aftësi financiare në shumën 266 137 lekë (sipas përlogaritjeve të kryera me çmimet e EKB-së), për të investuar në ndërtimin e kësaj pasurie të paluajtshme përgjatë viteve 1996 – 1998, si dhe për të përballuar shpenzimet familjare; ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me kohën e ndërtimit të kësaj pasurie; si dhe ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003, pasi nuk ka deklaruar shpenzime mbi 500 000 lekë, të bëra në vitet 2006, 2007 dhe 2008 për ndërtimin e kësaj pasurie.

Në lidhje me gjendjen *cash* në lekë, të identifikuar me nr. 4 dhe 5, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë.

Për pasurinë e identifikuar me nr. 7, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 319 074 lekë në vitet 2005 dhe 2006, për të investuar në blerjen e kësaj pasurie/automjet, për shlyerjen e kredisë në vitet në vazhdim, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

Për pasurinë e identifikuar me nr. 16, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të pagesave të kryera për këstin e parë dhe të tretë të saj.

Në lidhje me të ardhurat nga qiraja të pasqyruara në pikën nr. 17, subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën “Vetting”, mbi të ardhurat reale të përfituara nga qiraja e banesës së tij për vitet 2006 – 2007, të konfirmuara sipas transaksioneve bankare në shumën 2 713 725 lekë, krahasimisht me ato të deklaruara në deklaratën “Vetting”, në shumën 2 300 625 lekë; nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor, ligjshmërinë e burimit të të ardhurave nga qiraja për vitet 2006 dhe 2007, në shumën 2 713 725 lekë, dhe si pasojë subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Në tërësi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë burimet e pasurive në deklaratën “Vetting”, si dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të tyre dhe të të ardhurave me burim nga ushtrimi i profesionit të avokatit, sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

**B.** Lidhur me kontrollin e kriterit të figurës, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Keta, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

**C.** Lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues krijoi bindjen se mangësitë profesionale të konstatuara, nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti nuk ka arritur nivelin minimal kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas pikës 1/c, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

**KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura prej tij, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, mbështetur në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundim se subjekti i rivlerësimit:

Nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas gërmës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

**PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar, në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të gërmës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Hysen Keta, me funksion prokuror/drejtues pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 25.7.2019.

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Xhensila Pine**  
**Kryesues**

**Suela Zhegu**  
**Anëtar**

**Brunilda Bektashi**  
**Relator**

*Sekretare gjyqësore*  
*Denisa Kosta*